

PRINT ISSN 2080-3716
ONLINE ISSN 2304-2664

QENDRA PËR KËRKIME RAJONALE

**REVISTA SHKENCORE
PAVARËSLA**

VITI II, NR.1(2)

MAJ 2016

VLORE, 2016

Qendra për Kërkime Rajonale

REVISTA SHKENCORE PAVARËSIA

Viti II, Nr.1(2)

Maj 2016

Bordi Editorial

PROF.DR. LUAN GJONÇAJ - Kryeredaktor

PROF. DR. MUHARREM DEZHGIU

PROF.AS.DR. ENGJËLL LIÇAJ

PHD SIRI HOXHA

DR.VERONIKA DURMISHI

DR. EDMIRA CAKRANI

ARK. ARBEN MEKSI

DR. SILVANA SUKAJ

DR. MARJETA BONJAKO

Editor

Dr.Edmira Cakrani

As. Editor

Msc. Enerik Shabani

Qendra për Kërkime Rajonale nuk mban përgjegjësi për opinionet e shprehura nga autorët. Këto opinione janë qëndrime të autorëve të artikujve dhe nuk shprehin as qëndrimin e Qendrës për Kërkime Rajonale, as të SHPAL “Pavarësia”.

Botues

SHPAL “Pavarësia”

Bulevardi Vlorë-Skelë

PO.BOX 4358 AL-9401, Vlorë

ALBANIA

E-mail: gkr@unipavaresia.edu.al; www.unipavaresia.edu.al

COPYRIGHT © SHPAL “PAVARËSIA”, VLORË

ALL RIGHTS RESERVED

The idea of a united Europe and the establishment of KQEC	1
	<i>Dokt. Jeta Goxha</i>
Medical precautions “Mandatory treatment in a medical institution”. The actuality and the compliance of human rights implementation	6
	<i>Msc. Anila Dharmo (Fega)</i> <i>Iliba Bezati</i>
The concept of economic development according Amartyas Sen’s approach	14
	<i>Dokt. Ermira Sela</i>
Armëmbajtja pas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese	19
	<i>Mag. Florjan Kalaja</i>
The relationship between political elites and the democratization processes, an analytical overview. Case of Albania	44
	<i>Msc. Fabiola Deliaj</i>
Future challenges of public finances in Albania	50
	<i>Dr. Veronika Durmishi</i>
Identifying the factors that influence the growth of non-performing loans in the Albanian banking sector	63
	<i>Msc. Klodiana Dautaj</i> <i>Msc. Erola Isufi</i>
Relationship between real exchange rate and remittances in Albania	70
	<i>Dr. Edmira Cakrani</i>
Marketing as an important tool of the tourism development strategy in the region of Vlora	79
	<i>Dokt. Merita Murati</i>
Territorial employment pacts and their impact in Albania’s economy	91
	<i>Msc. Blerina Dhrami</i>
The foreign direct investment and arbitration in Albania	100
	<i>Dokt. Argita Lamaj</i>

Secure communication Ad-Hoc. An overview of two types of Ad-Hoc wireless networks, MANETs and VANETs	106
	<i>Dokt. Esmeralda Hoxha</i>
Web application for managing human resources on a contact center	118
	<i>Msc. Anduel Mehmeti</i>
Partitioning the blocks of a Steiner triple system into partial parallel classes	124
	<i>Msc. Jezerca Hodaj</i> <i>Prof.As. Melissa Keranen</i>
Le Corbusier, the autodidact student of visual art	130
	<i>Skerdilaid Hysenaj</i>
Vlora Waterfront	138
	<i>Flori Durmishi</i>

THE IDEA OF A UNITED EUROPE AND THE ESTABLISHMENT OF KQEC

PhD Candidate Jeta Goxha

Faculty of Economics and Social Sciences

Department of Law and Political Sciences

SHPAL "Pavarësia" Vlorë

ALBANIA

e-mail: jeta.goxha@unipavaresia.edu.al

ABSTRACT

The relationship between Western Europe countries that today are members of EU, were based on rivalry dhe distrust. The idea of a United Europe in that time was still a dream. Even that dream was destroyed for a time by the wars, that ravaged the old continent during the first half of the XX century. The tensions that sprang from this relationships, were the cause of two of the biggest wars of the XX century.

The author's aim in this research relates to her belief that the The European Community of the coal and steel plays an essential role in economic development, it is also the first step towards an important multi-disciplinary structure.

Culturor and linguistic differences prevailed, but not only, economic and political differences were a characteristic of Europe's countries. One good thing that came after the destruction brought on by the Second World War, was a new hope. The people that during the war had resisted the totalitarianism, were very decided in ending the rivalry and international hatred, to build a new and stable peace.

Between the years 1945 and 1950, a group of statesmen, including Robert Shuman, Konrad Adenauer, Alcide de Gaspari and Winston Churchill, had the goal of convincing their countrymen to enter a new era. New structures would be build in Western Europe, based on common interests and established based on deals that would guarantee the rule of law and equality between states.

Keywords: Western Europe, the Shuman plan, economic integrity, peace, prosperity

HYRJE

Ajo, që sot të gjithë e njohim si organizatën më të rëndësishme europiane, si në këndvështrimin politik edhe atë ekonomik, sot një strukturë ligjore dhe institucionale komplekse, është e vështirë të kuptohet pa marrë në analizë dhe shqyrtuar fillesat historike të njërit prej komuniteteve më të rëndësishme të Bashkimit Europian.

Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore u hodhën idetë e para për të ardhmen e Europës, ide, të cilat disa vite më vonë morën jetë dhe u bënë baza e integritimit europian.

Një prej ideatorëve më të rëndësishëm ishte Jean Monnet, i cili me 5 gusht 1943 gjatë një mbledhje të Komitetit të Çlirimit Kombëtar Francez deklaroi: "*Nuk do të ketë paqe në Europë,*

*në qoftë se shtetet janë krijuar mbi bazën e sovranitetit kombëtar¹ ... Vendet e Evropës janë shumë të vogla për t'u garantuar popujve të tyre prosperitetin e nevojshëm dhe zhvillimin social. Sipas deklaratimit të Monnet, kjo do të ishte e mundur vetëm nëse këto shtete bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën. Europa do të ishte e bashkuar nëse këto vende krijojnë një federatë. Pavarësisht idesë së Monnet, i cili u vijua nga një plan tjetër i rëndësishëm për Evropën, "Plani Shuman", sot Bashkimi Evropian është një organizatë *sui generis*.*

EVROPA E PASLUFTËS

Pasojat që la Lufta e Dytë Botërore në Evropë, pothuajse ishin të përmasave ekstreme: ekonomia e shkatërruar, vendbanime të rrënuara dhe miliona të vdekur. Për shekuj me rradhë Evropa ka qenë skenë tensionesh, konfliktesh dhe ndarjesh. Vetëm fill pas tmerreve të Luftës së Dytë Botërore, mund të themi se u vu re "një rigjallërim", i karakterizuar nga dëshira për të krijuar një klimë paqeje dhe bashkëpunimi. Udhëheqësit e Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkonin të vendosnin siguri dhe prosperitet në Evropën e pas luftës. Pasojat fatale ishin ende të pranishme, pavarësisht ndryshimeve që kishin ndodhur në Evropë pak vite pas mbarimit të Luftës së II Botërore. Ekspansioni sovjetik në Europë dhe ngjarjet e vitit 1948 në Çekosllovakia e bënë edhe më të fortë këtë ndjenjë. Të gjendur përballë një realiteti të tillë, disa qeveri europiane ndërmorrën iniciativën e mbrojtjes kolektive.

Lëvizjet e para mbarë evropiane, të cilat bënë thirrje për një Evropë të bashkuar dhe të lirë, lindën gjatë Luftës së Dytë Botërore. Qëllimi kryesor ishte bashkimi i shteteve, si në këndvështrimin ekonomik, ashtu edhe në atë dhe politik. Njëkohësisht, të shumta qenë përpjekjet për të siguruar një klimë të re paqeje dhe ndërmarrjen e një sërë iniciativash për parandalimin e konflikteve, që mund të merrnin jetë në një periudhë të mëvonshme.

Në fakt, pas Luftës së Dytë Botërore, kontinenti u nda përsëri, edhe pse u hodhën hapat e para të bashkëpunimit midis vendeve të Evropës Perëndimore. Marrëdhëniet ndërmjet vendeve pas Luftës së Dytë Botërore ndryshuan në mënyrë dramatike, si pasojë e një varg faktorësh politikë dhe ekonomike, të cilat mundësuan ndryshimin e qëndrimeve të shteteve evropiane dhe fillimin e bashkëpunimit dhe të integritetit evropian. Disa nga këta faktorë sollën formimin e organizatave ndërkombëtare të ndryshme në shkallë botërore dhe rajonale, të cilat siguruan frymën e bashkëpunimit dhe shkallën e ndryshme të integritetit ndërmjet vendeve anëtare.

Mënyra se si e konceptonte Jean Monnet realizimin e bashkimit evropian ishte krejt ndryshe nga projektet e mëparshme. Europa, sipas tij, do të bëhej duke filluar nga ndryshimi i kushteve ekonomike, të cilat përcaktonin edhe sjelljen njerëzore. (Paskal Milo, 2002). Normalisht, bëhej fjalë për një projekt mjaft ambicioz, i cili do të kishte vështirësi të gjente terren, të bëhej konkret në një klimë si ajo e pasluftës. Ideja fillestare ishte ajo e bashkimit të shteteve, si nga ana ekonomike, ashtu edhe ajo politike, në mënyrë që të parandalonte çdo lloj konflikti të ardhshëm dhe të garantonte një klimë paqeje. Plani ishte hartuar për të realizuar një kontroll të përgjithshëm të ekonomisë franceze, e cila kishte shfaqur shenja të një sëmundje serioze, që përpara fillimit të Luftës së Dytë Botërore (Desmond Dinan, *Historia e integritetit Evropian*).

¹ Jean Monnet u bë anëtar i Komitetit Francez për çlirimin kombëtar i qeverisë franceze në mërgim në Algjeri. pikërisht në këtë moment u krijua, vizioni i tij për një bashkim të Evropës, për të rifituar dhe mbajtur paqen.

PLANI SHUMAN DHE LINDJA E KEQÇ

Robert Shuman, i inspiruar nga një ide fillimisht e krijuar nga Zhan Mone, më 9 Maj 1950, propozoi formimin e Komunitetit Evropian për Qymyrin dhe Çelikut (KEQÇ). Vendet, që dikur kishin luftuar njëri-tjetrin, prodhimin e qymyrit dhe të çelikut e bashkuan nën një institucion të përbashkët, të quajtur “Autoriteti i Lartë”.

Në mënyrë tejet simbolike, por në të njëjtën kohë edhe praktike, “mbeturinat e luftës” u shndërruan në instrument pajtimi dhe paqe. Në deklaratën e tij Robert Shuman, propozoi krijimin e një tregu të përbashkët me dy sektorë të veçantë, që kohë më parë ishin përdorur vetëm për qëllime ushtarake, si ai i qymyrit dhe i çelikut.

Robert Shuman deklaronte se “Europa nuk do të bëhej e gjitha menjëherë, ose sipas një plani të vetëm. Ajo do të ndërtohet nëpërmjet arritjeve konkrete”(shiko ne:Dadalo-Europe). Objektivi i një integrimi kompleks i vendeve evropiane ishte projekti i një të ardhmeje të afërt, por që do të realizohej në mënyrë graduale.

Shuman deklaroi se një Evrope e bashkuar ishte themelore për paqen botërore dhe se armiqësia e vjetër midis Francës dhe Gjermanisë duhej eliminuar. Si masë e parë për realizimin e këtij qëllimi, ai propozoi të vihej gjithë prodhimi franko-gjerman i qymyrit dhe çelikut nën mbikëqyrjen e një autoriteti të lartë të kontrolluar, në të cilin mund të bënin pjesë edhe vende të tjera evropiane (Iva Zajmi, *E Drejta Europiane*, 2008).

Kjo nënkuptonte integrimin e Gjermanisë në KEQÇ së bashku me Francën si nga pikëpamja ekonomike, po ashtu edhe nga ajo politike. Shuman mbronte idenë e transferimit të sovranitetit një autoriteti më të lartë dhe të pavarur, që do të ushtronte kompetencat në këta sektorë, të cilat më parë drejtoheshin nga vetë shtetet dhe do të merrte vendime që do t’i detyronin këto te fundit (*Historiku i integritit të Bashkimit Evropian*, Qendra për kërkim dhe zhvillim). Kjo nënkuptonte që bashkëpunimi midis këtyre vendeve do të ishte krejt ndryshe nga ai që kishte ekzistuar më parë.

Lindja e KEQÇ, ishte hapi i parë drejt bashkimit të Europës: themeluesit e saj mendonin që ky organizëm të mbijetonte ishte e nevojshme të shkohej më tej.

OBJEKTIVAT DHE PRITSHMËRITË E KEQÇ

Me lindjen e këtij Komunitetit të ri u krijua një strukturë e re mbi kombëtare e pajisur me institucione të krijuara posaçërisht për të (E.Canaj, S.Bana, *E Drejta e Bashkëpunimit Evropian*). Pavarësisht thirrjeve të drejtuara vendeve evropiane, vetëm pesë prej tyre u përgjigjën pozitivisht – Gjermania, Italia, Holanda, Luksemburgu dhe Belgjika. Pra, marrëveshja e Parisit për formimin e KEQÇ-së, në vitin 1951 u nënshkrua nga gjashtë vendet e para anëtare dhe hyri në fuqi në 25 Korrik të vitit 1952.

Ky Komunitet kishte një afat 50-vjeçar dhe pushoi së ekzistuari në vitin 2002. Ndërkohë, në vitin 1957 me Traktatin e Romës u krijuan Komuniteti Ekonomik Evropian (KEE) dhe Komuniteti i Energjisë Atomike (EUROATOM) (*Manuali i Proçesit të integritit*, 2009).

Objektivat e Komunitetit (KEQÇ) ishin themelimi i një zonë të lirë tregtare dhe vendosja e themeleve për krijimin e tregut të përbashkët të lëndëve të para themelore në shtetet e industrializuara – qymyrit dhe çelikut.

Në këtë mënyrë u krijua një Organizatë e një tipi krejtësisht të ri. Behej fjalë jo vetëm për një zonë tregtie të lirë, por edhe për ngritjen e një tregu të përbashkët, kjo në fakt në një fushë me rëndësi të jashtëzakonshme për periudhën e atëhershme.

Shtetet anëtare ua kaluan një pjesë të konsiderueshme të sovranitetit të tyre institucioneve të sapokrijuara mbi kombëtare.

Por, pavarësisht arsyeve ekonomike, një prej objektivave themelore të KEQÇ ishte krijimi i një terreni të bazuar në paqe dhe bashkëpunim. Vendet që më parë ishin urryer, kishin luftuar kundër njeri-tjetrit do të kishin mundësinë të bashkëjetonin, duke hequr dallimet që ekzistonin midis Europës dhe Europës Perëndimore. Një ndër objektivat kryesore ishte vendosja e një rendi të ri, paqes, në Europën e pasluftës. Rajon i cili kishte qenë vatra e intrigave dhe katastrofave jo vetëm ekonomike por edhe njerëzore. Gjetja e një mekanizmi të përshtatshëm ishte urgjente.

Pikërisht në një moment të tillë KEQÇ do të shënonte përpjekjet e para drejt integritit evropian, të cilat realisht kishin marrë jetë shumë dekada më parë.

Me këtë marrëveshje u vendosën institucionet qendrore me karakteristika mbikombëtare si: Autoriteti i Lartë, Këshilli i Ministrave, Parlamenti dhe Gjykata e Drejtësisë, të cilat ishin të autorizuar të vendosnin taksa për prodhimin e qymyrit dhe të çelikut me të cilat financoheshin veprimtaritë e Komunitetit (KEQÇ) dhe të vendosin lidhur me çështjet si: heqja dhe ndalimi i barrierave doganore, përcaktimi i çmimeve në raste të caktuara ose caktimi i minimumit dhe i maksimumit të taksave doganore për importin e qymyrit dhe të çelikut nga vendet e treta.

Gjashtëdhjetë e dy vjet më vonë një propozim i tillë mund të duket i parëndësishëm, mund të konsiderohet pak më shumë se një marrëveshje e tregtare ndërmjet dy shteteve. Por, në fakt ajo ishte e bazuar në një qëllim që më vonë do të rezultonte revolucionar.

PËRFUNDIME

Nëse sot BE-ja karakterizohet si unitet në progres i kontinentit të Evropës, është rrjedhojë e zhvillimit dhe e ngjarjeve në gjysmën e dytë të shekullit XX-te, gjatë kësaj periudhe për Evropën më shumë ishin karakteristike ndarjet, antagonizmat dhe interesat e ndryshëm, sesa objektivat e përbashkëta.

Gjatë kësaj periudhe KEQÇ paraqitej si e vetmja formë e mundshme e integritit evropian mbi kombëtar. U promovua “në një kontekst demokracie dhe paqe” e cila do të lejonte shtetet më të rëndësishme evropiane në një moment të vështirë historik, të rilindnin. Lindja e KEQÇ ishte akti i parë i rëndësishëm, që do të hapte rrugën drejt Bashkimit Evropian, e cila do të merrte jetë 45 vjet më vonë.

Nga njëra anë, arsyeja politike e kësaj nisme, ishte eliminimi i konflikteve ndërmjet vendeve evropiane, në veçanti midis Francës dhe Gjermanisë, nëpërmjet një politike të përbashkët mbi kombëtare të qymyrit dhe Çelikut.

Nga ana tjetër arsyeja ekonomike, e cila ishte bazuar në besimin se rimëkëmbja ekonomike e vendeve që do të bëheshin pjesë e Komunitetit do të bazoheshin në këta dy sektorë.

Përvoja tregoi se themelimi i KEQÇ ishte tejet pozitiv, jo vetëm për rezultat e drejtpërdrejta, por edhe për faktin, sepse hapi rrugën për formimin e subjekteve të tjerë të ngjashëm në sektorë ekonomik, të cilët morën jetë disa vite më vonë.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian ishte pritur dhe kërkuar që në fillim me qëllim ndërtimin e një Evrope të fortë dhe të bashkuar në diversitet, e cila vazhdon vlerat demokratike mbi të cilat është themeluar.

REFERENCA

Desmond Dinan, *Historia e integritit evropian*, Shtëpia botuese Instituti i Studimeve ndërkombëtare, Tirane, fq 21.

Sokol Bana E. Canaj, S. Bana, (2014). *E drejta e bashkëpunimit evropian*. Shtëpia botuese “Onufri”, fq 17.

Girolamo Strozzi, (2004). *Diritto dell’Unione Europea*, Parte istituzionale: Dal trattato di Roma al trattato di Nizza, Giappichelli editore, Torino, fq. 25.

Iva. Zajmi, (2008). *E drejta evropiane*. Shtëpia botuese EKD, Tirane, fq 15-20.

Paskal Milo, *Bashkimi Evropian. Ideja, integriti, identiteti, e ardhmja*. Shtëpia botuese “albPAPER”, Tirane 2002, fq 27.

Manuali i procesit të integritit evropian. European Movement in albania, Shtypur në Shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese FLESH, Tiranë, Shkurt 2009, fq. 17-20.

Historiku i integritit të Bashkimit Evropian, Qendra për kërkim dhe zhvillim. Shiko në www.qkzh.org/publications/HistorikuiIntegrititBE.pdf, fq 5.

Nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në Traktatet e Romës. Shiko në http://www.dadalos-europe.org/alb/grundkurs_3/etappe_1.htm, fq. 13.

**MEDICAL PRECAUTIONS “MANDATORY TREATMENT IN A MEDICAL
INSTITUTION”
THE ACTUALITY AND THE COMPLIANCE OF HUMAN RIGHTS
IMPLEMENTATION**

MSc AnilaFega-Dhamo
Faculty of Economics and Social Sciences
Department of Law and Political Sciences
SHPAL “Pavarësia” ,Vlorë
ALBANIA
e-mail: anilafega@unipavaresia.edu.al

Iliba Bezati
Appeals Court, Vlorë
ALBANIA
e-mail: ilibabzt@gmail.com

ABSTRACT

Insanity, incapacity because of a mental disorder, refers to the subjective reasons of criminal liability. In this paper, in addition to dealing with juridical or medical criteria irresponsibility due to the mental state of a person, is also stated the problematic of putting into practice the measure of “mandatory medication in a medical institution”, which is given to people who are responsible of a penal act, in conditions of inability to understand and control their actions. This treatment becomes meaningful and important in conditions when the compliance and the implementation of basic human rights is questionable in any way of individuals’ treatment, keeping also in consideration the category of people stated above. The main discussion theme, analyzing the actuality and the perspectives, we have tried to touch the public sensitivity, asking the question: Besides treating and separating them from the society, as a danger source, how willing is the Albanian society to assure the accomplishment of respecting the human rights standard in this process?

Keywords: incapacity, mental disorder, criminal liability, medical measures

HYRJE

Në qendër të punimit do të jetë trajtimi i personave ndaj të cilëve gjykata cakton “*masën mjekësore të mjekimit të detyrueshëm*”. Ajo, që kemi dashur të tregojmë është se, kategoria e personave ndaj të cilëve gjykata cakton masën mjekësore “*mjekim i detyruar në një institucion*” trajtohen sikur ndaj tyre të jetë caktuar masë ndëshkimore.

Në praktikë vihen re problematika në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të kësaj natyre nga organizmat përgjegjës, duke mos marrë masat e nevojshme si dhe për të ngritur strukturat e duhura, që të mundësojnë trajtimin në raport me qëllimin e masës së caktuar, ashtu edhe për të rritur nivelin profesional të tyre.

Trajtimi i personave të deklaruar si të papërgjegjshëm me vendim të gjykatës në institucione penitenciare, vë në dyshim qëllimin për të cilin caktohen masat mjekësore, shërimin e tyre, duke qenë i papërputhshëm me kushtet shëndetësore të tyre. Ndihma mjekësore e disponueshme në spitalet e burgut apo në burg nuk është në të njëjtin nivel si ndihma që ofrohet në institucionet e specializura mjekësore e që në raste të caktura mund të sjellë dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore të personave. Mbjajtja e personave me masë mjekësore, në mënyrë të padrejtë në

institucionet e Ekzekutimit të Dënimeve Penale, përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

METODAT

Materialet shkencore të përdorura për këtë çështje janë kryesisht legjislacioni penal shqiptar, por edhe ai i BE ,me qëllim qasjen teorike të problemit , si metodë e përshtatshme studimi që jep mundësi interpretimi të materialeve të përdorura. Po ashtu, nuk është lënë pa përdorur edhe metoda krahasuese, për të krahasuar përmbajtjen e një instituti me atë të një tjetri. Është ndërthurur gjithashtu metoda sasiore në lidhje me paraqitjen e gjendjes së fenomenit.

Papërgjegjshmëria për Shkak të Gjendjes Mendore dhe Masat Mjekësore

Në të drejtën penale është i rëndësishëm instituti i përgjegjësisë penale. Ligji ynë penal pasqyron dallimin midis përgjegjësive penale dhe përgjegjshmërisë. Subjekti është element i domosdoshëm i veprës penale, me të cilin kuptohet personi që ka kryer veprën penale dhe që do të përgjigjet për kryerjen e saj, pra që i nënshtrohet përgjegjësisë penale. Që të përgjigjet penalisht ai duhet të ketë dy cilësi, moshën për përgjegjësi penale dhe përgjegjshmërinë. Element tjetër i domosdoshëm është edhe ana subjektive, me fajin, motivet dhe qëllimin.

Baza e përgjegjësisë penale përbëhet nga tërësia e elementëve objektivë dhe subjektivë të parashikuar në legjislacionin penal, të mjaftueshëm për marrjen e personit në përgjegjësi penale (Elezi,etj,2001:122) dhe kjo përgjegjësi lind në momentin e kryerjes së veprës penale. Përgjegjësia penale nënkupton detyrimin e autorit të veprës penale që t'i nënshtrohet procedimit penal dhe sanksionit, që ligji parashikon për veprën penale të kryer prej tij. E parë në këtë këndvështrim ajo paraqet lidhje të ngushtë me përgjegjshmërinë e personit, me aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij si dhe për të dëshiruar ardhjen e pasojave dhe do të gjykohet në lidhje me momentin e kryerjes së veprës penale.

Doktrina vë në dukje se, aftësia për të kuptuar është aftësia e autorit për t'u orientuar në botën e jashtme, në kuadër të perceptimit të drejtë të realitetit dhe në përmbushje të plotë të sjelljeve të veta dhe ndikimit që mund të ketë. Aftësia për të kuptuar identifikohet me vendosmërinë në raport në raport me impulse normale ,të cilat janë baza e sjelljeve që kryen subjekti. Kodi Penal i RSH në lidhje me këtë përdor shprehjen “nuk ka qënë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij “. ¹ E drejta penale shqiptare e bazon papërgjegjshmërinë në dy kritere, kriterin mjekësor dhe kriterin juridik (Elezi etj,2001:121).

Duke iu referuar nenit 17 të Kodit Penal, kriteri mjekësor, në formulën e papërgjegjshmërisë identifikohet me shprehjen: “*vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor*”. (Myftari,2014:39).

Ndërkohë kriteri juridik formulon shkallën e rëndesës së sëmundjes psikike, që përjashton aftësinë e të kuptuarit të fajit. Ky kriter përcakton se, deri në çfarë pike duhet të arrijnë çrregullimet mendore, që t'a bëjnë personin të paafte për të kuptuar rëndësinë e veprës, që ai kryen, pra, që e bëjnë atë të papërgjegjshëm.

¹ Neni 17 i KPenal përcakton se : “*Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor, dhe për pasojë nuk ka qënë në gjendje të kontrollojë veprimet ose mosveprimet dhe as të kuptojë se kryen vepër penale.*”

Tek personi i papërgjegjshëm mungon një nga elementët thelbësorë të veprës penale, faji. Pa faj s'ka vepër penale dhe pa vepër penale s'ka përgjegjësi penale. Përgjegjshmëria prezumohet, ndërsa papërgjegjshmëria provohet dhe deklarohet nga gjykata (Muci,2012:156).Ndaj këtyre personave nuk mund të zbatohen dënime penale, pasi, jo vetëm që mungon elementi i fajit, por në vetvete dënimi do të ishte i padobishëm dhe i pakuptimtë si dhe nuk do të ndikonte në riedukimin e tyre.

Çdo vendim papërgjegjshmërie për shkak të gjendjes mendore sjell një pasojë të caktuar, konkretisht pushimin e çështjes dhe vendosjen e masës shtrënguese. I pandehuri, nisur nga rrezikshmëria e tij shoqërore, mund t'i nënshtrohet një trajtimi ambulator, ose mjekimi të detyruar në një institucion mjekësor(Myftari,2014:84)

Në KP të RSh masat mjekësore janë parashikuar në nenin 46 të tij², duke u vendosur në të njëjtën dispozitë me masat edukuese e në të njëjtin kre me atë të dënimeve penale, pavarësisht se ato janë të ndryshme nga dënimet penale e të përbashkët me to kanë vetëm karakterin shtrëngues shtetëror. Ato nuk kanë elementët e ndërkimit, por kanë për qëllim shërimin e subjektit nëpërmjet trajtimit mjekësor të detyrueshëm dhe të kurave sa më të përshtatshme. Është kjo arsyeja që Kodi Penal nuk cakton kohëzgjatjen e masës mjekësore. Këtë kohëzgjatje nuk e cakton as gjykata në vendimin e saj, e cila ka detyrimin që, pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit të marrë në shqyrtim vendimin e saj. Gjukata në këtë rast mund të vendosë vazhdimin e masës ose ndryshimin e saj³.

Mjekimi i Detyruar në një Institucion Mjekësor dhe Ekzekutimi

Aktualisht, për personat e shpallur nga gjykata si të papërgjegjshëm, vendoset masa mjekësore **mjekimi i detyruar ambulator** ose **mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor**.

Vihet re se, gjykata në një pjesë të vendimeve të saj për masa mjekësore të detyrueshme, përcakton në mënyrë të gabuar vendin se ku do të ekzekutohet masa, duke specifikuar kështu institucionin penitenciar, duke referuar Qendrën Spitalore të Burgjeve dhe IEVP Zahari, Krujë. Për një pjesë tjetër gjykata përcakton vetëm se ky vendim duhet të ekzekutohet në një institucion mjekësor ose psikiatrik. Edhe në praktikë këta persona qëndrojnë momentalisht në Spitalin e Burgut⁴ apo pranë IEVP Krujë, ndërkohë që Institucionet e përfshira nuk e kanë gjetur zgjidhjen praktike të problemit.

² Neni 46 i K.Penal parashikon se “Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Masat mjekësore janë: 1. Mjekimi i detyruar ambulator 2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor .”

³ Gjukata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.7/406, datë 27.05.2013 ,lënë në fuqi me vendimin Gjykatës së Apelit Durrës me vendimin nr.10-2013-1058 (144), datë 26.06.2013 ,dhe me vendimin n **Nr.00-2014-385 i Vendimit (27)** të Gjykatës së Lartë ka vendosur:

Të pranojë kërkesën e kërkuarit A.L.B.

Të zëvendësojë masën mjekësore mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor për A.L.B., të vendosur me vendimin nr.406, datë 04.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me mjekimi i detyruar ambulator, në bazë të nenit 46 të K.Penal.

Mjekimi i përcaktuar nga mjeku psikiatër i Rrethit Durrës të zbatohet nga V .B. dhe A. B. Njoftimin e prokurorit të ekzekutimeve nga V. B. dhe A. B., në rast se A.L. B. nuk merr mjekimin ambulator të përcaktuar nga mjeku psikiatër.

⁴ Sipas ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 329, dt. 15.01.2009 “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar, spitali i burgut konsiderohet burg i sigurisë së zakonshme dhe jo institucion mjekësor.

Vendi ku mbahen dhe trajtohen personat e deklaruar të papërgjegjshëm, nuk janë institucione mjekësore të posaçme, sikurse parashikohet në aktet e cituara më sipër, por janë institucione të ekzekutimit të vendimeve penale me kushte burgu dhe izolimi të plotë.

Këta persona, edhe sot e kësaj dite janë të akomoduar në sistemin e burgjeve, gjë që përbën shkelje të të drejtave të njeriut. Fakti është bërë publik edhe nga organizma të ndryshëm. Numri total i personave që ndodhen në sistemin e burgjeve, ndaj të cilëve me vendim të gjykatës është dhënë masa “mjekim i detyruar” është 99. Sipas studimit të Neli (2010), 59 prej tyre janë akomoduar në Q.S. Burgjeve dhe 40 në I.E.V.P. Krujë. Në shërbim të këtij kontigjenti tepër problematik shërbejnë vetëm dy mjekë psikiatër, që në raport me numrin e personave me probleme të shëndetit mendor është krejtësisht i pamjaftueshëm.

Nga monitorimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit është ngritur gjithmonë si problem dhe mosstrehimi në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë nga gjykata masë mjekim të detyruar, megjithë hapjen e sektorëve të veçantë në paraburgim (Avokati i Popullit, 2012, 2013).

Edhe në konstatimet më të fundit të Avokatit të Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës theksohet se: *“Trajtimi i kësaj kategorie në IEVP, në kushtet kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm”* (Avokati i Popullit, 2015).

Por sa është juridikisht korrekt kjo gjendje?

Më sipër kemi referuar nenin 46 të K.Penal, sipas të cilit gjykata për personat penalisht të papërgjegjshëm vendos edhe “mjekimin e detyrueshëm në një institucion mjekësor”.

Në ligjin nr.44/2012, “Për shëndetin mendor”, neni 28, pika 1, përcaktohet se: **“Institucionet mjekësore të posaçme** janë institucionet, që shërbejnë për trajtimin e personave me ç’rregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer vepra penale, për të cilat gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të dënuarve, që shfaqin ç’rregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion të posaçëm në bazë të nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale.”

Sipas këtij ligji, struktura monitoruese të zbatimit të tij janë Komiteti Kombëtar i Shëndetit Mendor, i cili është organ këshillimor i Ministrisë të Shëndetësisë si dhe Avokati i Popullit (funksion i atribuar nga një rezolutë e veçantë e Kuvendit të Shqipërisë, si detyrim ndërkombëtar, që buron nga protokollin opsional i Konventës Kundër Torturës (OPCAT) i OKB-së, i ratifikuar nga vendi ynë). Pra, ligji përjashton çdo lloj varësie dhe monitorimi nga Ministria e Drejtësisë, ashtu sikurse janë institucionet ku mbahen personat aktualisht.

Duke iu referuar dokumentit *“Mbi Rregullat Europiane të Burgut”*, miratuar nga Këshilli i Evropës dhe deleguar për zbatim me rekomandimin Nr.87/3, të Këshillit të Ministrave, të vendeve anëtare, ndërmjet shumë rregullave të këtij dokumenti, sipas 100.1, përcaktohet se: *“Personat, që konstatohen me probleme të shëndetit mendor nuk duhet të mbahen në burg, por duhet të dërgohen sa më shpejt që të jetë e mundur nga burgjet në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”*.

Sipas rregullores së Përgjithshme të burgjeve⁵: *“Trajtimi në institucionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet për aq kohë sa gjykata nuk shprehet për trajtimin e tyre në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për shëndetin mendor”*.

⁵ neni 15, pika 6 i Rregullores.

Sa më sipër, e gjithë situata aktuale e trajtimit mjekësor të personave të deklaruar të papërgjegjshëm nga gjykata, për të cilët është caktuar masa “mjekim i detyruar në institucion mjekësor”, bie ndesh me të gjithë kuadrin ligjor, që rregullon problematikën në fjalë duke krijuar një situatë paligjshmërie të patolerueshme.

Masa “Mjekim i Detyruar në Institucion” dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut

Personat me masa mjekësore, në mënyrë të padrejtë vazhdojnë të mbahen në Institucione penitenciare, duke përbërë kështu një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2014:74).

Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, nuk mund të kryhet me mbajtjen e këtyre personave në institucionet e Ekzekutimit të Dënimeve Penale, duke i trajtuar si masa sigurimi apo dënime penale; sa më sipër, është e patolerueshme situata në të cilën këta persona mjekohen brenda ambienteve të sistemit të burgjeve.

Mbrojtja e dinjitetit njerëzor në aplikimin e masave shtrënguese, sidomos tek ato që sjellin privim të lirisë (shtrimi i detyruar në spital psikiatrik dhe vendosja e të miturit në institucion riedukimi) gjen kuptim tek shprehja "respektim i personalitetit, dinjitetit, etj", (Myftari, 2014:84)

Konstatohet se, këto shkelje të të Drejtave të Njeriut, vijnë në kundërshtim edhe me nenin 15 dhe 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilës: Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”

Mbajtja dhe trajtimi i personave, për të cilët gjykata cakton masë mjekësore mjekim i detyrueshëm në institucionet e vuajtjes së dënimeve penale përbën shkelje edhe të nenit 3 të Konventës së të Drejtave të Njeriut. Neni 3 i Konventës flet për një ndër vlerat më themelore të një shoqërie demokratike. Ai ndalon në mënyrë absolute torturën, trajtimin ose dënimin çnjerëzor dhe degradues, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës⁶, duke u vendosur detyrime shteteve të mbrojnë mirëqënien fizike të personave me liri të kufizuar, qoftë edhe atyre të vendosur në masa shtrënguese. Personat e tillë kanë statusin juridik të të sëmurit mendor dhe gjendja shëndetësore e tyre është absolutisht e papërputhshme me gjendjen në të cilën ata vendosen.

Sipas praktikave të GJEDNJ ky lloj trajtimi është degradues, për sa kohë i shkakton viktimës ndjenja frike, ankth dhe inferioritet, si pasojë e poshtërimit dhe përruljes, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike çon në trajtimin degradues në kuptim të Konventës. Mungesa e qëllimit për t'a përrulur dhe poshtëruar viktimën nuk e përjashton përfundimisht shkeljen e nenit 3 të saj. Sipas këtij neni, shteti duhet të garantojë që një person të trajtohet në kushtet, të cilat janë në pajtim me dinjitetin njerëzor, që mënyra apo metoda e ekzekutimit të këtyre masave të mos e nënshtrojnë atë ndaj ankthit apo mundimit të një intensiteti të tillë, që e kapërcen nivelin e pashmangshëm të vuajtjes, e cila është prezent në burg.⁷

Mbajtja e këtyre personave në IEVP vjen në kundërshtim edhe me nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, pasi të sëmuret mendorë nuk mund të diskriminohen për shkak të statusit të tyre si persona me probleme të shëndetit mendor.

Personat, ndaj të cilëve është dhënë masë mjekësore e tillë duhet të kenë akses në shërbimet shëndetësore të vlefshme pa diskriminim për shkak të gjendjes së tyre ligjore. Në kushtet kur

⁶ shih Labita k. Italisë, nr. 26772/95, § 119, ECHR 2000-IV)

⁷ Cështja Dybeku kundër Shqipërisë.

mjekimi psikiatrik i tyre në IEVP është bazuar në përgjithësi në farmakoterapinë pa programe për trajtim individual apo psikoterapi individuale, terapi profesionale apo terapi në grup, ky trajtim është i papërshtatshëm, pasi mjekimi psikiatrik duhet të bazohet në trajtimin individual, i cili nënkupton hartimin e një plani konkret trajtimi për çdo pacient, duke përcaktuar qëllimin e mjekimit, kuptimin e terapisë së përdorur dhe anëtarët e personelit përgjegjës. Plani i trajtimit duhet të përmbajë gjithashtu rezultatin e rishikimit të herëpashershëm të kushteve të shëndetit mendor të pacientit dhe një rishikim të mjekimit të pacientit.

Duke e konsideruar trajtimin sipas përshkrimit më sipër, këtij grupi personash duhet t'u garantohet trajtim i barabartë, jodiskriminues, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre duhet të bëhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me ç'rregullime të shëndetit mendor. Referuar ligjit nr.44/2012, "Për shëndetin mendor", personat me ç'rregullime të shëndetit mendor duhen trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor, në një mjedis sa më pak shtrëngues, nga ekipe multidisciplinare, që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit⁸.

REKOMANDIME

Të gjithë personat e papërgjegjshëm, që kanë kryer vepra penale, ndaj të cilëve është vendosur masë mjekësore "mjekim i detyruar në një institucion mjekësor", në shkallë vendi, vazhdojnë të ruhen dhe të trajtohen në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë dhe pjesërisht në I.E.V.P. Krujë. Për t'i dhënë zgjidhje gjendjes së paligjshmërisë së këtij problemi, duhet të që të angazhohen të gjithë institucionet brenda vendit si dhe organizmat e huaja, që vëzhgojnë respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e personave të privuar nga liria në veçanti, me qëllim marrjen e masave për ruajtjen dhe trajtimin mjekësor të këtyre personave në një objekt të posaçëm.

Ndërtimi i një institucioni të ri sipas standardeve ndërkombëtare do të ishte një zgjidhje ligjore, në kushtet kur këta persona nuk mund të ruhen dhe të trajtohen në institucione të zakonshme psikiatrike, pasi nuk ekzistojnë kushtet e sigurisë dhe si pasojë mund të ndodhin ngjarje të rënda kriminale. Persona të tillë mund të paraqesin rrezikshmëri për shoqërinë si dhe pacientët e tjerë në spitalet e zakonshme psikiatrike, prandaj kërkohen kushte të veçanta sigurie, që mund të garantohen vetëm me krijimin e institucioneve të posaçme për këtë qëllim.

REFERENCAT

Dokumenti "Mbi Rregullat Europiane të Burgut",

ECHR *Peers v. Greece*, no. 28524/95, § 74

ECHR 2001-III; *Kalashnikov v. Russia*, nr.47095/99, § 101

ECHR 2002-VI dhe *Ramirez Sanchez v. France* [GC], no. 59450/00, § 119

⁸ Neni 5 i ligjit

Elezi I., Kaçupi S., Haxhia M., “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë,2001.

GJEDNJ, çështja Grori k.Shqipërisë nr. 25336/04 , ECHR 2009

GJENDNJ,çështja Dybeku kundër shqipërisë(ankimi nr.41153/06)

Kushtetuta e RSH

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si edhe protokollet e saj shtesë

Konventa kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimit Mizer, Çnjerëzor e Degradues,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit , *Raport studimor për vendimet e prokurorisë për mosfillimin dhe pushimin e procedimeve penale & procedurat për ekzekutimin e vendimeve penale*, Tiranë 2014

Ligji Nr. 44/2012 datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”;

Ligji Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar;

Muci Sh. E drejta penale ,Tiranë 2012 ,shtypshkronja “Gutenberg”

Myftari K. Tema e doktoraturës ,*Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore,kriteri juridik në të drejtën penale*.

Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT),

Raport i Avokatit të Popullit .*Aktiviteti i Avokatit të popullit në rolin e mekanizmit kombëtar të parandalimit të Torturës,Tiranë 2012*.

Raport i Avokatit të Popullit .*Aktiviteti i Avokatit të popullit në rolin e mekanizmit kombëtar të parandalimit të torturës .Tiranë 2013*

Raport i Avokatit të Popullit, *Raport vjetor për veprimtariëe e Avokatit të Popullit*, viti 2015
Revista "Shëndeti mendor dhe të drejtat e njeriut", Volumi 2 ,2010.

Vendimi Nr. 437, datë 20.5.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së
Përgjithshme të Burgjeve"

Vendimi Nr.00-2014-385 (27) të Gjykatës së Lartë

THE CONCEPT OF ECONOMIC DEVELOPMENT ACCORDING AMARTYA SEN'S APPROACH

PhD. Candidate Ermira Sela

Faculty of Social Sciences
Department of Political Sciences
University of Tirana

ALBANIA

e-mail: ermirasela@hotmail.com

ABSTRACT

The concept about the development of society is seen in different ways by different authors. One of them, which analyzes and proposes an alternative solution from traditional ways, is Amartya Sen. He places emphasis on strengthening the capabilities of people. In fact, to estimate the quality of life we have to rely on all the factors that can influence the advancement of the individual in society. The individual success at work or life is not completed with the possession of deep knowledge. Above all, it is clear that this success depends on individual's own skills to use his knowledge in a more efficient and intelligent way. So we can underline that, already, the formation should have an important place at every stage of the individual's life and in all areas. Precisely for this, education has gained more and more a leading place in the political programs of developed societies. The main object of this essay is the analysis on the concept of society development, according Amartia Sen's approach. The method used is qualitative.

Keywords: education, unemployment, development

HYRJE

Kriza aktuale ekonomike botërore imponon një reflektim mbi konceptin e zhvillimit të shoqërisë. Libri i Amartya Sen "Zhvillimi si Liri", analizon dhe propozon zgjidhje alternative nga mënyrat tradicionale të konceptimit të zhvillimit. Ai e vendos theksin mbi fuqizimin e aftësive të individit dhe jo thjesht në përqëndrimin e politikave, që do të sillnin një rishpërndarje të të ardhurave. Për të vlerësuar cilësinë e jetës, si në nivel social dhe individual nuk është e mjaftueshme të studiohet vetëm aftësia për të shpenzuar e individëve. Ajo duhet të bazohet mbi aftësitë që zotëron një individ, aftësi, që shkojnë përtej prodhimit dhe zotërimit të të mirave dhe përfshijnë të gjithë atë kompleks faktorësh, që mund të influencojnë avancimin e jetës të individit, si: niveli i autonomisë individuale, shëndeti, sistemi i arsimit, cilësia e ambientit, niveli i demokracisë, etj. Tashmë është e qartë se transformimet ekonomike dhe ato në tregun e punës po iu japin gjithnjë dhe më shumë rëndësi atyre individëve që i zotërojnë këto aftësi dhe që përshtaten me ndryshimet e vazhdueshme¹. Si shembull mund të themi se, të kontribuosh në luftimin e

¹ "Janë aftësitë e vet individit që përcaktojnë qasjen e tij në tregun e punës; nëse aftësitë e individit për punë janë të ulta ai do të ketë vështirësi të hyjë në tregun e punës ose do të largohet shumë shpejt prej tij; në të kundërt kur aftësitë për punë janë të larta, punëmarrësi do të shtyhet ta punësojë ose do ta mbajë në forcat e tij të punës nëse tashmë punon". Shih Vanessa Boretti: "Aspetti teorico metodologico e applicazione al programma di interventi formative dell'Istruzione e Formazione Tecnica Superiore (IFTS)"; fq. 121

papunësisë, (një nga plagët më të mëdha të shoqërive), do të thotë të shtosh nivelin e aftësive të një individi në mënyrë që ai të jetë i përshtatshëm për punë.

Individi nuk i shpëton dot logjikës së progresit të vazhdueshëm, që karakterizon shoqërinë modernë; për këtë arsye, ai duhet të përditësohet vazhdimisht me njohuritë e reja. Pikërisht, për këtë, politikat në arsim zënë një vend kryesor në programet politike të shoqërive.

Objekti i këtij artikulli është dhënia e një panorame të përgjithshme të politikave arsimore në Shqipëri, që janë ndjekur nga aktorët zotërues të pushtetit politik.

KONCEPTI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, SIPAS AMARTYA SEN

Ekonomia është faktor kryesor në jetën politike dhe sociale të çdo vendi dhe individi. Megjithatë, përvoja ka treguar se tregjet nuk mund t'i përballojnë dot me mekanizmat e tyre paregullsitë në ciklet ekonomike, *dështimet e tij çojnë drejt rezultateve ekonomike inefficente, të cilat mund të korrigjohen vetëm prej ndërhyrjeve publike (Samuelson, 1998)*

Ka shumë koncepte mbi politikën publike; një prej tyre është përcaktimi i saj si masë e ndërmarrë për t'iu përgjigjur një problemi të caktuar social². Pra, politikat publike kanë si qëllim të përcaktojnë ndërhyrjen efektive për trajtimin e problemeve sociale, gjithashtu, ato mbështesin ndërhyrjet në favor të rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Me konceptin e rritjes në përgjithsi tregohet procesi i shtimit të të ardhurave kombëtare të një vendi, kurse koncepti i zhvillimit është më i gjerë dhe lidhet me aspekte të tjera të ndryshimit të ekonomisë dhe të shoqërisë, p.sh. shpërndarja e të ardhurave, kushtet e jetesës, niveli i arsimimit, etj. Sipas Amartya Sen (2009), zhvillimi duhet të *“shihet si një proces i shtrirjes së lirive substanciale që njeriu gëzon”*. Në këtë kuptim, *“zhvillimi kërkon mënjanimin e burimeve kryesore që çojnë në privimin e lirisë (Sen,2009:23)* midis të cilave urinë, mjerimin, tiraninë, intolerancën, analfabetizmin, mungesën e kujdesit shëndetësor, etj. Të gjitha këto e kufizojnë individin, mundësinë dhe aftësinë e tij për të ndërtuar jetën që preferon.

Liria, e kuptuar si mundësi për të zgjedhur jetën më të denjë, është sipas Sen kriteri bazë sipas të cilit duhet të orientohen politikat publike.

Analiza e tij zhvillohet mbi dallimin midis funksioneve dhe aftësive; funksionet janë gjendje të qëni ose të bëri, të cilave njerëzit iu kushtojnë rëndësi (p.sh. të ushqyerit në mënyrë të përshtatshme, mosvuajtja nga sëmundjet e kurueshme, etj), kurse aftësitë janë kombinimet e funksioneve, që një individ është në gjendje të realizojë. Tashmë, vazhdon Sen(2009:104), *“ndërsa kombinimi i funksioneve të njeriut pasqyron arritjet e tij aktuale, tërësia e aftësive përfaqëson lirinë për realizimet: kombinime të funksioneve nga të cilat njeriu mund të zgjedh”*.

Aftësitë dhe funksionimet nuk varen vetëm nga të mirat në dispozicion të një individi, por edhe nga faktorë të tjerë, personalë (inteligjenca, paaftësitë, gjinia), socialë (niveli i arsimit publik, cilësia e kujdesit shëndetësor, niveli i dhunës dhe kriminalitetit), ambientalë (klima, burimet hidrike, niveli i ndotjes), etj. *“Për shembull, një njeri me paaftësi mund të ketë një shportë më të madhe artikujsh bazë dhe përsëri të ketë më pak mundësi për të bërë një jetë normale, sesa një njeri i shëndetshëm me një shportë më të vogël artikujsh bazë(Sen,2009:103)”*

Si pasojë, për të rritur cilësinë e jetës së individit, barazia e funksioneve dhe aftësive është thelbësore. Në veprën e Sen, njeriu konceptohet si subjekt veprues, që mund të zgjedhë midis disa alternativave dhe të realizojë një jetë sipas vlerave të tij.

² *“Problemet sociale, shpesh konceptohen si situata që përkeqësojnë jetën e një numri të konsiderueshm individësh duke sjellë pasojë të padëshirueshme për shoqërinë në përgjithësi”*

Nëpërmjet kriterit të lirisë autori merr në shqyrtim problemin e varfërisë dhe të pabarazive sociale. Sen evidenton sesi vlerësimi i këtyre problemeve, vetëm mbi bazën e të ardhurave, është i pamjaftueshëm për të kuptuar dhe gjetur ndonjë zgjidhje të mundshme. Si varfëria, ashtu dhe pabarazia, janë përcaktuar nga autori si paaftësi, pra, si element, që i heqin subjektit mundësinë për të disponuar liritë themelore për të jetuar mirë. Në këtë kuptim, për përmirësimin e cilësisë së jetës, janë të nevojshme përhapja dhe zhvillimi i kujdesit shëndetësor dhe arsimimit. “*Sa më gjithëpërfshirës të bëhet arsimimi dhe kujdesi shëndetësor, aq më shumë ka të ngjarë që edhe një njeri potencialisht i varfër të ketë mundësi më të mira për të kapërcyer skamjen*(Sen,2009:122)”. Pra, qasja e Sen është e ndryshme nga qasjet “klasike” në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave. Në veçanti, ai kundërshton utilitarizmin³, mospërfilljen në shpërndarjen e lumturisë, mospërfilljen e të drejtave, lirive dhe shqetësimeve të tjera, përveç përfitimit; një lloj predispozicioni për të favorizuar përshtatjen ndaj kushteve sociale. Sipas Sen, qëllimi i politikave sociale nuk duhet të jetë dhe aq shpërndarja e burimeve kryesore, por krijimi i hapësirave të lirisë reale me qëllim që një individ mund të realizojë qëllimet dhe vlerat e tij.

ROLI I ARSIMIT NË SHOQËRITË AKTUALE

Midis shumë mënyrave për të përkufizuar shoqërinë aktuale, ajo e *learning-society*, duket plotësisht efikase, përderisa “*thekson aspektin përcaktues si përhapje të njohurive dhe të aftësive në çdo aspekt të jetës, në mënyrë individuale dhe kolektive, si në punë, ekonomi, në politikat integruese, me të njëjtën shpërndarje dhe përqëndrim global të pushtetit dhe të pasurive* (Alberici, 2002)

Është pra, një shoqëri që transmeton njohuri të reja, e cila stimulon qytetarët, duke nxitur, aftësinë për t’u pajisur me dije dhe për të artikuluar të dhëna dhe njohuri të reja. Për këto arsye, investimi në burimet njerëzore është kthyer në domosdoshmëri dhe arsimiti luan rolin kryesor. Si thekson dhe Sen, në analizën ekonomike bashkohore, “*theksi ka kaluar nga vlerësimi i akumulimit të kapitalit në termat fizikë, në vlerësimin e tij si një proces ku cilesia prodhuese e qënieve njerëzore është pjesë integrale*”⁴.

Në studimet për rritjen ekonomike, vihet re një theks shumë i madh mbi “kapitalin njerëzor”, sepse, përmes edukimit, të mësuarit dhe formimit njerëzit mund të bëhen shumë më prodhues me kalimin e kohës dhe kjo ndihmon në procesin e zhvillimit ekonomik. Kjo përjashtë ka çuar drejt konceptimit të arsimit dhe të zhvillimit individual të bazuar mbi një vision ekonomik. Përmendim këtu, raportin e OSBE-së (viti 1989), të titulluar “*Education and the economy in a changing society*”, në të cilin, faktor kyç konsiderohet aftësia e individit për të përballuar ndryshimet dhe për t’i transformuar në avantazhe të ardhshme.

Në fakt, përveçse shkencës dhe teknologjisë, theksi vendoset tek rëndësia që ka disponimi i kapitalit njerëzor shumë të kualifikuar në mënyrë që të vazhdohet me ritjen ekonomike, shtimin e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë.

Sipas Sen, literatura mbi kapitalin njerëzor ka prirjen të përqëndrohet në rolin e qënieve njerëzore për rritjen e mundësive të prodhimit, duke e anashkaluar plotësisht larine, që kanë njerëzit për të bërë atë jetë, që ata e vlerësojnë si më të arsyeshme. Në rast se arsimimi e bën një

³ Koncepti qëndror i të gjitha teorive utilitariste është koncepti *utilitet*. Në vija të përgjithshme me utilitet kuptohet ajo veti në çdo objekt që çon kah prodhimi i të mirës më të madhe të përgjithshme. Utilitarizmi mund të lejojë një shpërndarje të padrejtë të vlerave sociale themelore në qoftë se rritet sasia e të mirës në shoqëri.

njeri më të efektshëm në prodhimin e mallrave, atëherë kjo duket qartë që është një rritje e kapitalit njerëzor. Kjo i shtohet vlerës së prodhimit në ekonomi, si dhe të ardhurave të personit që është i arsimuar. *“Por, edhe me të njëjtin nivel të ardhurash, një person mund të përfitojë nga edukimi – me leximin, komunikimin, diskutimin, aftësimin për të zgjedhur në mënyrë më të bazuar, duke qënë i vlerësuar më seriozisht nga të tjerët (Sen, 2002).* Pra, përfitimet e arsimitit e tejkalojnë rolin e tij si “kapital njerëzor”. Në këtë këndvështrim, ndryshimi në konceptimin e arsimit, si më të lidhur me nevojat sociale të shoqërisë, fillon me raportin Delors *“Lifelong Learning for All”* të publikuar nga UNESCO me (1996), ku evidentohet se progresi i individit varet, jo aq nga rritja ekonomike, sesa nga një zhvillim personal më i gjerë. Raporti thekson se edukimi është në qendër të zhvillimit të individit dhe të komunitetit dhe detyra e tij është të zhvillojë kapacitetet dhe aftësitë e fshehura të individit. Edhe *“Strategjia e Lisbonës”* (2000), ndër dokumentat kryesorë të Bashkimit Europian në lidhje me arsimin vendos si objektiv të saj për t’u përshtatur arsimin dhe formimin me nevojat e qytetarëve në të gjitha fazat e jetës së tyre për të promovuar punësimin dhe perfshirjen sociale.

ARSIMI NË SHQIPËRI

Përsa i takon shoqërisë shqiptare ,duhet të theksojmë se në dekadat e fundit ajo është përballuar me nevojën e ngutshme për reforma të thella për vendosjen e ekonomisë se tregut dhe të ndërtimit të një sistemi qeverisës demokratik.

Një nga ndryshimet me të rëndësishme, të ndërmarra mbas viteve ’90, ishte reformimi i sistemit arsimor, i cili *“preku të gjithë elementet, me një intensitet të lartë e shpesh të paqëndrueshëm, duke reflektuar më së miri realitetin shoqëror të tipit tranzitor (Nathanaili, 2001)*

Ashtu si legjislacioni shqiptar në tërësi, edhe ai arsimor është fryt i përpjekjeve për t’u përshtatur me standartet demokratike ndërkombëtare, përkatësisht akteve të OKB-së dhe atyre europiane.

Sipas strategjisë kombëtare të arsimit, objektivi prioritar në fushën e arsimit është *“promovimi i shoqërisë së dijes, zhvillimi i kapitalit njerëzor, dhe ndërthurja e teknologjisë moderne me mësimdhënien dhe mësimnxënien në funksion të progresit ekonomik të vendit dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare me standarte bashkëkohore europiane”*(MASH, 2009)

Në këtë kontest, politikat në arsim synojnë të përmirësojnë cilësinë e tij, të zgjerojnë aksesin, të përshpejtojnë dhe forcojnë futjen e teknologjive të reja, etj.

Pikërisht një nga sfidat aktuale të arsimit shqiptar është dhe investimi në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Të dhënat tregojnë se në Shqipëri niveli i edukimit teknologjik është i ulët, madje në grupmosha të caktuara mungon totalisht. Ky përbën një fakt shqetësues nëse kihet parasysh se shkenca, teknologjia dhe inovacioni janë faktorë të domosdoshëm për të përballuar sfidat e një bote të globalizuar, gjithnjë e më shumë konkurruese.

Në fakt, kompetiviteti i Shqipërisë në arenën rajonale është akoma tepër i ulët dhe bazohet kryesisht mbi kostot e faktorëve të prodhimit , (p.sh. në koston e ulët të punës).

“Rritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional, sigurimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit, pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë, përmirësimi i strukturave të arsimit dhe trajnimit, realizimi i autonomisë shkollorë nëpërmjet reformës arsimore, në bashkëpunim dhe me grupet e interesit”(MASH, 2009), janë linjat kryesore mbi të cilat duhet të zhvillohen politikat në arsim.

Për të vazhduar në rrugën e progresit, Shqipëria ka nevojë për një popullsi të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nga tregu i punës. Në këtë kontekst, forcimi i arsimit

përbën domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Pra, çështja e arsimimit në vend është kusht për t'u zhvilluar ekonomikisht, për të qënë konkurrues, për të tërhequr investimet e huaja dhe luftuar shumë nga plagët e shoqërisë shqiptare, siç është papunësia.

PËRFUNDIME

Shoqëria bashkëkohore i ofron individit mundësi dhe perspektiva më të mëdha se në të kaluarën, por nga ana tjetër paraqet reziqe më të larta. Reziku më i madh është shfaqja e një ndarje midis një pakice individesh, që kanë aftësi të mjaftueshme për të mbijetuar në realitetet komplekse dhe atyre, që nuk i zotërojnë këto aftësi dhe për pasojë janë të përjashtuar prej ndryshimeve ekonomike dhe sociale që ndodhin në shoqëri.

Në këtë kontekst, arsimimi kthehet për individët në domosdoshmëri, jo vetëm për të përgatitur individë, që të konkurojnë në tregun e punës, por, mbi të gjitha, për t'i pajisur ata me aftësi, që do t'i ndihmojnë të zgjedhin jetën, që vlerësojnë si më të përshtatshme.

Strategjitë politike të zhvillimit duhet të fokusohen edhe në zgjerimin e sistemeve të arsimimit dhe formimit, duke i garantuar çdo qytetari zhvillimin e plotë të kompetencave bazë, kompetenca në fushën e teknologjive të informacionit, gjuhëve të huaja, kulturës teknike, sociale, etj.

Si thekson dhe Amatrja Sen, “*arsimimi është një e mirë shumë e rëndësishme, sepse përfaqëson një nga institucionet, që nuk i përkasin tregut, të afta për të garantuar mbrojtjen e individit*”. Niveli i zhvillimit të një shoqërie varet nga aftësia e saj për t'iu garantuar të gjithë individëve një sërë aftësish, që do të çojnë drejt një ëell-being të përgjithshëm.

REFERENCA

Alberici, A. (2002) *Imparare sempre nella societa della conoscenza*. Milano; Mondadori.

Boretti, V. “*Aspetti teorico metodologici e applicazione al programma di interventi formative dell'Istruzione e Formazione Tecnica Superiore (IFTS)*”

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, “*Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013*”, www.mash.gov.al

Nathanaili, V. (2001) *Reforma dhe legjislacioni në arsimin parauniversitar*. Tiranë; UFO Press.

Samuelson, P. (1998) *Economia*. Milano; McGraw-Hill Libri Italia srl.

Sen, A. (2009) “*Zhvillimi si Liri*”, Tiranë; Botimet Dudaj.

ARMËMBAJTJA PAS SHFUQIZIMIT NGA GJYKATA KUSHTETUESE

Mag. Florjan Kalaja
Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë

ABSTRAKT

Gjykata Kushtetuese me Vendimin Nr. 9, datë 26.02.2016 vendosi ndër të tjera: “*Shfuqizimin e...paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014*”. Problemet dhe debatet e praktikës gjyqësore pas kësaj vendimmarrje janë të shumta, e kryesisht lidhen me faktin nëse ky vendim shfuqizues e dekriminalizoi veprën penale të armëmbajtjes pa leje në ambiente publike; nëse ky vendim shfuqizues *ipso legge* ka ngjallur normën e shfuqizuar më parë nga norma e shfuqizuar tashmë; nëse gjykatat duhet të zbatojnë në këto figura të veprës penale paragrafët ekzistues pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pavarësisht se titulli i shkrimit fokuson vetëm figurën e veprës penale të armëmbajtjes pa leje, të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, në të vërtetë, në shkrim trajtohen të gjitha problematikat që kanë dalë në praktikë mbi shfuqizimin e paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal. Kjo do të thotë se, shkrimi merret edhe me figurën e veprës penale të mbajtjes pa leje të minave, bombave, lëndëve plasëse, apo edhe me ish-paragrafin e cilësuar si kryerja e veprave me sasi të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë dhe kur ka sjellë pasoja të rënda.

Shkrimi synon të adresojë zgjidhje kushtetuese për situatën faktike dhe juridike të krijuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Nëpërmjet analizës historike të veprës penale të armëmbajtjes pa leje, nëpërmjet analizës së filozofisë së vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe analizës së jurisprudencës së Gj.E.D.Nj. mbi nenin 7 të K.E.D.Nj., do të argumentohet qëndrimi mbi zgjidhjen e kazuseve që ka krijuar në praktikë vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Sigurisht, trajtimi nuk synon të jetë ezaurues, por synon të jetë një përpjekje modeste për të kontribuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe në praktikën gjyqësore të gjykatave të apelit apo gjykatave të shkallës së parë. Shpresoj që ky punim të jetë një fillësë debati doktrinar mbi zgjidhjen apo zgjidhjet, që mundet të adresohen në lidhje me kazusin kushtetues, që nga krijuar ky precedent në Shqipëri. Ndaj, të gjitha opinionet kundra, paralele apo sugjeruese janë të mirëpritura, në mënyrë që debati doktrinar të formësohet.

HYRJE

Historikisht, mbajtja e armëve dhe e lëndëve plasëse, pa lejen e organeve kompetente në Shqipëri është konsideruar nga ligji vepër penale. Kodi Penal i vitit 1959, në nenin 273, nën titullin “*Fabrikimi, mbajtja ose shitja e armëve*”, parashikonte ndër të tjera se: “*Fabrikimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve të zjarrit, të luftës dhe lëndëve plasëse pa lejen e organeve përkatëse, dënohet: me heqje të lirisë gjer në pesë vjet dhe me konfiskimin e armëve dhe të lëndëve plasëse.*”¹

¹ Shpallur me Dekretin Nr. 2868, datë 16.3.1959 “*Mbi shpalljen e Kodit Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë*” i aprovuar nga Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë me Ligjin Nr. 1470, dt. 23.05.1952 dhe i ndryshuar me Dekretin Nr. 2477, dt. 03.06.1957 dhe me Ligjin nr. 2804, dt. 04.12.1958.

Më tej, Kodi Penal i vitit 1977 në nenin 224, nën titullin “*Prodhimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve*”, parashikonte ndër të tjera se: “*Prodhimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve dhe e lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente dënohen: me riedukim nëpërmjet punës, ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.*”²

Pas ndryshimeve thelbësore që përjetoi shoqëria dhe shteti shqiptar me përmbyshjen e regjimit komunist, legjislatorit iu shtrua si detyrë kryesore hartimi i një Kodi Penal të ri. Në datën 01.06.1995 hyri në fuqi Kodi Penal³, që, pavarësisht ndryshimeve të herëpashershme, që ndoshta kanë humbur edhe identitetin dhe koherencën e tij në vetvete, është akoma edhe sot në fuqi. Në nenin 278, me titull “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit*”, u parashikua se: “*Prodhimi i armëve dhe i municionit luftarak, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Mbjajtja, blerja ose shitja e armëve, bombave apo minave pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet. Mbjajtja e fishekëve të armëve të lehta luftarake pa leje të organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.*”⁴

Ndryshimi i parë i nenit 278 i Kodit Penal do të vinte gati një vit më vonë, nëpërmjet Ligjit nr. 8175, datë 23.12.1996 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"*”. Neni 28 i këtij ligji ndryshonte nenin 278 të Kodit Penal: “*Prodhimi i paligjshëm i mjeteve ose pajisjeve që konceptohen, funksionojnë dhe përdoren për vrasje ose plagosje, pavarësisht nga destinacioni i tyre si armë luftarake, gjuetie a sporti dënohet me pesë vjet burgim. Prodhimi i armëve të ftohta pa leje të organeve kompetente, si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjete të tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje dënohet me një vit burgim.*”

Nuk kaloi shumë dhe këto dënime fikse në shtetin tonë, ndër më fillestarët në demokracinë europiane, u shfuqizuan nga Gjykata Kushtetuese⁵. Ajo që bie në sy është se, Gjykata Kushtetuese në këtë vendim shfuqizon vetëm sanksionet e dispozitave penale, për të cilat në përfundim të shqyrtimit rrëzon prezumimin e kushtetutshmërisë dhe nuk shfuqizon të gjithë veprën penale. Nën të njëjtin, kazu vite më vonë, gati 19 vjet më vonë, dispozitivi do të jetë krejt ndryshe.

² Ligji nr. 5591, datë 15.6.1997 Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Sipas nenit 248, Kodi Penal ka hyrë në fuqi në datën 01.10.1977.

³ Shiko nenin 335 të Kodit Penal.

⁴ Shiko Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Fletore Zyrtare nr. 3, Mars 1995.

⁵ Shiko Vendimin Nr.13, datë 29.5.1997 të Gjykatës Kushtetuese. Ndër të tjera në vendim argumentohet se: “Gjykata çmon se parashikimi i sanksioneve (dënimeve) fikse në normat e sipërpërmendura të Ligjit nr.8175, bie ndesh me një sërë parimesh (dispozitash) të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal, sidomos për mënyrën e caktimit të dënimit, për rrethanat lehtësuese e rënduese (nenet 47-50), të cilat kur konkurrojnë, vlejnë, papërrjashtim, për çdo veprë penale. Sanksionet fikse eliminojnë mbrojtjen përse i përket përcaktimit të shkallës së rrezikshmërisë së veprës së kryer e të autorit të saj dhe gjykatës i heqin mundësinë e individualizimit të dënimit, duke cunuar kështu funksionin e saj në dhënien e drejtësisë. Si rrjedhojë, me sanksionet fikse çënohen të drejtat themelore të njeriut, të garantuara me parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim të drejtë (nenet 38 e 40 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”) dhe si të tilla duhet të shfuqizohen.

...Meqënëse vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pjesën që shfuqizon sanksionet dhe dispozitat e ligjit objekt shqyrtimi, sipas dispozitave kushtetuese (neni 26 paragrafi i tretë) hyn në fuqi vetëm pas shpalljes së tij në Fletoren Zyrtare, për të parandaluar efektet negative të mëtejshme të sanksioneve të shfuqizuara, Gjykata çmon se në bazë të nenit 24 pika 10 të ligjit kushtetues, duhet të vendoset pezullimi i menjëhershëm i zbatimit të tyre dhe zbatimi i normave të Kodit Penal.”

Ndryshimi i dytë i nenit 278 të Kodit Penal në fuqi do të bëhej tre vjet më vonë. Në vitin 1998 legjislatori në nenin 278, pas fjalëve “minave”, në paragrafët e parë dhe të dytë, do të shtonte fjalët “lëndët plasëse”.⁶ Kështu, në vitin 1998, neni 278 i Kodit Penal formulohej: “*Prodhimi i armëve dhe i municionit luftarak, i bombave apo minave lëndët plasëse, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Mbajtja, blerja ose shitja e armëve, bombave apo minave lëndët plasëse, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet. Mbajtja e fishekëve të armëve të lehta luftarake pa leje të organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.*” Pa lakimin e drejtë gjuhësor dhe pa lidhëzat e detyrueshme sipas ligjesisë së gjuhës shqipe, dispozita në paragrafin e parë dhe të dytë formulohej paksa pa kuptim, megjithatë kjo pakuptimësi gjuhësore nuk afektonte në zbatimin e ligjit penal në praktikë.

Ndryshimi i tretë i nenit 278 të Kodit Penal do të vinte pas gjashtë vitesh nga miratimi i tij dhe pas tre vitesh nga ndryshimi i parë. Kësaj rradhe legjislatori ndërhynte në sanksionin e çdo paragrafi dhe në figurat konkrete të veprës penale, ndryshonte paragrafin e tretë dhe shtonte edhe një paragraf të katërt. Ndryshimet ishin: “*Në nenin 278 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: - Në paragrafin e parë, fjala “pesë” bëhet “tre”. - Në paragrafin e dytë, hiqen fjalët “blerja ose shitja”. - Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon: “Mbajtja e municionit luftarak pa leje të organeve kompetente shtetërore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.” - Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Kur vepra kryhet në sasira të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”*”⁷

Kështu në vitin 2001 neni 278 i Kodit Penal sanksiononte se: “*Prodhimi i armëve dhe i municionit luftarak, i bombave apo minave lëndët plasëse, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Mbajtja, e armëve, bombave apo minave lëndët plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet. Mbajtja e municionit luftarak pa leje të organeve kompetente shtetërore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kur vepra kryhet në sasira të mëdha në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*”

Ndryshimi i katërt i nenit 278 të Kodit Penal do të vinte 18 vjet pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal, 15 vjet pas ndryshimit të parë dhe 12 vjet pas ndryshimit të dytë. Kësaj rradhe ndryshimet ligjore rritën ndjeshëm sanksionet e veprës penale dhe u shtua edhe një paragraf tjetër në dispozitë. Kështu, në vitin 2013 legjislatori i dha këtë formulim nenit 278 të Kodit Penal: “*Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Mbajtja e armëve, i bombave apo minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Mbajtja e armëve, i bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në*

⁶ Shiko nenin 3 të Ligjit nr. 8279, datë 15.1.1998 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

⁷ Shiko nenin 60 të Ligjit nr. 8733, datë 24.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.”⁸

Ndryshimi i pestë i nenit 278 të Kodit Penal do të vinte 19 vjet pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal, 16 pas ndryshimit të parë të dispozitës, 13 vjet pas ndryshimit të dytë dhe një vit pas ndryshimit të tretë. Kështu në vitin 2014, kryesisht i ndikuar nga problematika e madhe që shkaktoi realiteti i shpërthimeve dhe atentateve me lëndë plasëse, legjislatori bëri këto ndryshime: “1. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë: “Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”. 2. Pas paragrafit të tretë shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje: “Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.”. 3. Paragrafi i katërt ekzistues bëhet paragrafi i pestë. 4. Paragrafi i pestë ekzistues bëhet paragrafi i gjashtë dhe në këtë paragraf fjalët “dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet” zëvendësohen me fjalët “dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet”.”⁹

Kështu në vitin 2014 neni 278 i Kodit Penal sanksiononte se:

“Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet. Mbajtja e armëve, i bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.”.

Ndryshimi i gjashtë i nenit 278 të Kodit Penal do të vinte 20 vjet pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal, 17 pas ndryshimit të parë të dispozitës, 14 vjet pas ndryshimit të dytë, dy vjet pas ndryshimit të tretë dhe një vit pas ndryshimit të katërt. Ky ndryshim është i katërti dhe i fundit deri më tani i bërë nga ligjvënësi. Ndryshimi i vitit 2015 ishte se: “Në nenin 278, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje: Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave ose minave pa lejen e organeve kompetente shtetërore dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët dhe municionet luftarake dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”¹⁰

Sot, pa patur parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese, neni 278 i Kodit Penal sanksionon se:

⁸ Shiko nenin 43 të Ligjit Nr. 144/2013, datë 2.5.2013. Drejtëshkrimi i mangët i dispozitës, nga ndryshimet që përjetoi neni 278 i Kodit Penal në vitin 1998, duket se u zgjidh pa ndryshime ligjore, por vetëm nga korrigjimet e Qendrës së Botimeve Zyrtare. Shiko Fletoren Zyrtare Nr. 83, dt. 20.05.2013, faqen 3526. Sipas nenit 49 ky ligj ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Sipas përllogaritjes del se ligji ka hyrë në fuqi me datë 04.06.2013.

⁹ Shiko nenin 5 të Ligjit Nr. 98/2014, datë 31.07.2014. Shiko Fletore Zyrtare Nr. 132, dt. 19.08.2014, faqe 6020. Neni 9 i Ligjit përcakton se, ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Sipas përllogaritjeve del se ky ligj ka hyrë në fuqi me datë 03.09.2014.

¹⁰ Shiko nenin 17 të Ligjit 135/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 249, dt. 14.01.2016.

“Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëdhjetë vjet.”¹¹

Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave ose minave pa lejen e organeve kompetente shtetërore dënohet me burgim nga pesë deri në pesëdhjetë vjet.

Falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët dhe municionet luftarake dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Mbatja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Mbatja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Mbatja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet. Mbatja e armëve, i bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.”

Ndryshimi i shtatë i nenit 278 të Kodit Penal erdhi nga Vendimi Nr. 9, dt. 26.02.2016 i Gjykatës Kushtetuese. Nëpërmjet një kontrolli incidental, Gjykata e Apelit Vlorë kërkoi para Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e paragrafit të katërt të nenit 278 të Kodit Penal¹². Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, jo vetëm që shfuqizoi tërësisht paragrafin e katërt të nenit 278 të Kodit Penal, por shfuqizoi kryesisht¹³ dhe tërësisht edhe paragrafin e pestë të kësaj dispozite. Gjykata Kushtetuese vendosi ndër të tjera: *“Shfuqizimin e...paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014”*, që do të thotë paragrafin e katërt të para ndryshimeve të vitit 2014.

Në të vërtetë, formulimi i dispozitivit të Gjykatës Kushtetuese është i paqartë dhe nuk ka gjetur teknikën më të mirë ligjore për të artikuluar pjesën vendimmarrëse, e cili është pjesa më e rëndësishme. Megjithatë, paragrafët e shfuqizuar arrihen të kuptohen nga pjesa argumentuese e dispozitës.¹⁴ Thënë më qartë dhe pa ekuivok, me Vendimin 9/2006 Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar paragrafët e nenit 278 të Kodit Penal që disponojnë: 1. *“Mbatja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise*

¹¹ Normalisht duhet të jetë një gabim në shkrim dhe në botim sanksioni prej pesëdhjetë vjetësh në këtë Fletore Zyrtare dhe kësaj rradhe Qendra e Botimeve Zyrtare nuk del në rolin e ndreqësit të gabimeve pa ligj, por në rolin e gabimbërësit pa ligj. Logjika ta do të sanksioni nuk është pesëdhjetë vjet por pesëmbëdhjetë vjet, duke parë edhe historikun e dispozitave dhe përmbajtjen e tyre. Por logjika ndonjëherë mundet të bëjë edhe lojra dhe të pretendojë se në të vërtetë sanksioni maksimal që ka dashur të parashikojë legjislatori është dhjetë vjet dhe për rrjedhojë fjala “pesë” është lapsus. Akoma më shumë një logjikë tjetër finoke mundet të pretendojë në gjykim se sanksioni maksimal që legjislatori ka dashur të parashikojë ka qenë pesë vjet dhe se fjala “dhjetë” është lapsus. Dhe në këtë mënyrë çdo interpretim do të shkaktonte vështirësi të shkeljes dhe zbatimit të parimit të ligjshmërisë në të drejtën penale *“nullum crimen sine legge”*.

¹² Që ishte në fuqi në kohën kur kontrolli incidental është inicuar.

¹³ Gjykata Kushtetuese u shpreh se: *“6. Gjithashtu, gjykata referuese, edhe pse pranon se i mungon kriteri lidhës me çështjen konkrete, për paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të nenit 278 të KP-së, i kërkon Gjykatës Kushtetuese që bazuar në nenin 48 të ligjit nr.8577, datë 10.10.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të çmojë të shprehet me nismën e saj edhe për këto dispozita.”*

¹⁴ Gjykata Kushtetuese shprehet se: *“5. Në paragrafin e katërt të nenit 278/4 të KP-së përcaktohet se “mbajtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet” (në vijim gjykata do t’i referohet si paragrafi i pestë, pasi me ligjin nr.98/2014, që ka ndryshuar nenin 278, paragrafi i katërt ekzistues është bërë paragrafi i pestë).”*

publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”, dhe; 2. “Kur vepra kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.”.

Sot, duke patur parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese, neni 278 i Kodit Penal sanksionon se: *“Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave ose minave pa lejen e organeve kompetente shtetërore dënohet me burgim nga pesë deri në pesëdhjetë vjet.*

Falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët dhe municionet luftarake dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.”.

Ditët e fundit është bërë zyrtare nisma e Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin e tetë ligjor të rradhës, të nenit 278 të Kodit Penal.¹⁵ Procedurat e miratimit po zhvillohen aktualisht dhe së shpejti neni 278 i Kodit Penal do të ndryshojë sërish. Sërish parashikohet se asnjë nga figurat e veprës penale të parashikuara në këtë dispozitë nuk do të dekriminalizohet.

Nga analiza historike e mësipërme konkludohet se, asnjëherë në Shqipëri, që nga ligji penal material i parë i marrë në analizë e deri në ditët e sotme, armëmbajtja pa leje ka qenë konsideruar veprim i ndaluar nga ligji penal. Gjithnjë, mbajtja e armëve, bombave, minave ose e lëndëve plasëse, pavarësisht vendit se ku ato mbahen, pa lejen e organeve kompetente, ka qenë konsideruar nga ligji penal material si vepër penale.

Kontrolli Incidental dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata e Apelit Vlorë kërkoi, nëpërmjet gjykimit incidental kushtetues, shfuqizimin e nenit 278 paragrafi i katërt i Kodit Penal, me pretendimin se vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Gjykata sollti në vëmendje se, ndryshimet e ndërmarra nga ligjvënësi në dispozitat objekt shqyrtimi (por edhe të tjera të shqyrtuara më parë nga kjo Gjykatë), kanë qenë përgjithësisht spontane, nisur nga synimi për të luftuar kriminalitetin, por pa iu nënshtruar më parë studimeve të thelluara për të shmangur prishjen e balancave, jo vetëm midis masave të dënimit të veprave penale të një kapitulli, por edhe në raport me veprat e tjera penale, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të tyre. Gjykata vlerësoi se një qasje (strategji) e tillë e gabuar ka deformuar strukturën e Kodit Penal, duke krijuar disproporcione të pashpjeguara (paarsyeshme) midis dënimeve të parashikuara për vepra të ndryshme të Kodit, në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës dhe të proporcionalitetit, në rastet e kufizimit të të drejtave dhe lirive të individit.¹⁶

Duke iu referuar doktrinës së të drejtës penale Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, prodhimi apo mbajtja pa lejen e organeve kompetente të armëve luftarake është element thelbësor i anës objektive të kësaj veprë penale. Kështu, vijon ajo, ligjvënësi e ka konsideruar vepër të

¹⁵ Shiko: <http://www.balkanweb.com/site/armembajtja-pa-leje-manjani-vendos-hartimin-e-nje-pr-ligji-te-ri/>.

¹⁶ Shiko Vendimin nr. 9, dt. 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese. Shiko gjithashtu Vendimin nr.12, datë 14.04.2010 dhe Vendimin nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese

dënueshme penalisht mbajtjen e armëve pa leje, pavarësisht nga qëllimi i mbajtjes së tyre (për t'i përdorur ose jo). Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese e vlerësoi të pajustificuar përpjekjen e ligjvënësit për të përcaktuar rrezikshmërinë e kësaj vepre penale dhe përcaktimin e masës së dënimit nisur nga kriteret të tilla, si lloji i armës luftarake, dhe në veçanti vendi i mbajtjes së tyre (banesë, automjet, vendi i punës, etj.). Për më tepër, Gjykata i konsideron joproportionale dallimet në masat e dënimit të paragrafit të pestë të Kodit Penal dhe paragrafëve të tretë dhe të katërt të këtij neni. Për ilustrim ajo solli në vëmendje një rast hipotetik, një qytetar që mban një armë pa leje në banesë për të mbrojtur pronën, veten apo familjen, dënohet nga një deri në pesë vjet burgim. I njëjti person kur armën e mban për të njëjtën arsye në automjetin e tij, dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se, armët nuk përfaqësojnë gjë tjetër, veçse mjetin për të kryer vepra të tjera penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të cilat prekin kryesisht marrëdhëniet shoqërore që lidhen me mbrojtjen e jetës. Në këtë kuptim, edhe dënimet e parashikuara për to duhet të jenë në proporcion të drejtë me natyrën e krimit të kryer nëpërmjet përdorimit të tyre.

Gjykata Kushtetuese e konsideroi joproportionale ndërhyrjen në paragrafin e pestë të nenit 278 të Kodit Penal, duke e krahasuar këtë dispozitë edhe me të tjera, që ndodhen në të njëjtin kre të Kodit, “*Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike*”. Kështu, trafikimi i armëve dhe municioneve, një krim ndërkombëtar, dënohet sipas Kodit Penal nga shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet burgim (*neni 278/a, paragrafi i parë*). Të njëjtën masë dënimi ligjvënësi ka parashikuar edhe për veprat penale të trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive (*neni 282/a, paragrafi i parë*), etj. Raste të tilla të krahasueshme, me qëllim nxjerrjen e konkluzionit të mungesës së proporcionalitetit në caktimin e dënimeve, Gjykata Kushtetuese mori në vijim të vendimit edhe nga seksione të tjera të Kodit Penal edhe nga ligje penale materiale simotra të rajonit.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se ligjvënësi ka cënuar edhe parimin e sigurisë juridike, pasi ky parim lidhet me plotësimin e disa kërkesave paraprake të detyrueshme gjatë procesit ligjvënës. Sipas Gjykatës, parimi i sigurisë juridike ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se me ndërhyrjen në nenin 278 të KP-së ligjvënësi nuk ka respektuar aspektin harmonik që duhet të kenë dispozitat e Kodit Penal, të cilat në tërësinë e tyre duhet të përbëjnë një entitet të vetëm, ku të bashkohen vlerat dhe parimet kryesore që udhëheqin këtë kod, që janë shteti i së drejtës, barazia para ligjit, drejtësia në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe humanizmi.

Më tej, Gjykata Kushtetuese *ex officio* mori në shqyrtim edhe paragrafin e gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal. Gjykata konstatoi kryesisht se paragrafi i gjashtë i nenit 278 të KP-së, mbarte të njëjtat probleme kushtetutshmërie si dhe paragrafi i pestë i nenit 278, i konsideruar si i papajtueshëm me Kushtetutën. Sipas Gjykatës Kushtetuese, edhe ky dënim është dukshëm joproportional. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se, dhe shprehja “*pasoja të rënda*” është e paqartë dhe lë vend për interpretime të ndryshme, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, për rrjedhojë edhe ky paragraf duhet shfuqizuar.

Pa sqaruar më parë nëse kishte pretendim dhe kush e bëri pretendimin për shfuqizimin e paragrafit 1, 3 dhe 4 dhe pse i mori në shqyrtim ato, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se, në to nuk u gjend asnjë element antikushtetutshmërie. Ajo u shpreh se: “*Ndërsa për pretendimin për shfuqizimin e paragrafëve 1, 3 dhe 4 të nenit 278 të KP-së, për shkak se bien në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës, Gjykata, pasi i mori në analizë, arriti në konkluzionin se nuk kanë elemente të papajtueshme me Kushtetutën.*”. Në vendimin e saj Gjykata Kushtetuese gjeti rastin

të përsërisë qëndrimin e mëparshëm dhe të sjellë në vëmendje të ligjvënësist se, ndërhyrje të tilla në Kodin Penal duhet të jenë realisht efektive, në mënyrë që t'i shërbejnë jo vetëm luftës ndaj kriminalitetit, por për më tepër parandalimit të kryerjes së veprave penale. Gjykata Kushtetuese evidentoi se eksperiencia ka treguar që ashpërsimi jo proporcional i sanksioneve penale nuk ka pasur gjithmonë ndikim pozitiv ose ndikimi ka qenë i papërfillshëm në arritjen e qëllimeve të legjislativitetit penal. Si pasojë, gjatë përcaktimit të dënimit, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit. Ai duhet që, nëpërmjet formulimit të sanksionit t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete, në përputhje me kërkesat e parimit të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit.¹⁷

Vendimi pati edhe qëndrim gjyqtarësh në pakicë, përse i përket kësaj pike të vendimmarrjes dhe çështjes së shtruar për zgjidhje. Pakica e gjyqtarëve ndër të tjera analizon se: *“Në rastin konkret, pakica vlerëson se interesi i ligjvënësist për forcimin e luftës ndaj kriminalitetit ka qenë mjaftueshëm i rëndësishëm për të ndërhyrë në nenin 278 të KP-së. Sipas pakicës, nga kërkuesi nuk janë paraqitur argumente të mjaftueshme për të vërtetuar që, ka pasur mjete të tjera më pak të ashpra për të arritur qëllimin e kërkuar, të cilat do t'a çonin Gjykatën në konkluzionin se ka mjete të tjera më pak kufizuese. Në këtë kuptim, pakica vlerëson se argumentet e shumicës për joproportionalitetin e mjetit të përdorur nga ligjvënësi në ashpërsimin e dënimit për veprën penale të parashikuar në paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së, nuk janë bindëse. Për më tepër, edhe krahasimi me kodet penale të vendeve të tjera europiane në këtë rast nuk mund të jetë kriter përcaktues për arritjen në konkluzione, pasi ashpërsimi ose zbutja e marzheve të dënimit varion nga situata e kriminalitetit në vend dhe ligjvënësi disponon mjetet e tij të reagimit për të përmirësuar situatën. Situatat mbi kriminalitetin në vende të ndryshme janë të ndryshme, për rrjedhojë edhe ndërhyrja mund të jetë në forma dhe mënyra të ndryshme.”*

Përveç këtyre konsideratave, gjyqtarët në pakicë vlerësuan se shumica me këtë vendim, duke shfuqizuar paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së, mund të krijojë paqartësi dhe pasiguri në organet ligjzbatuese dhe më konkretisht gjykatat e zakonshme, në lidhje me perspektivën e çështjeve konkrete, në gjykimin e autorëve të akuzuar për kategorinë e veprës penale-objekt shqyrtimi. Gjithashtu, ato mbajtën qëndrimin se, për shfuqizimin me nismën e Gjykatës, të paragrafit të gjashtë të nenit 278 të KP-së, pakica i qëndron së njëjtës linjë të argumenteve për rrëzimin e kërkesës, si për paragrafin e pestë të nenit 278 të KP-së.

Dilemat Kushtetuese post Shfuqizimit

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mbi kontrollin incidental të inicuar nga Gjykata e Apelit Vlorë u njoftua publikisht, nëpërmjet njoftimit në fazën zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese, me date 10.12.2015.¹⁸ Reaksioni i shkaktuar ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte tepër i madh. Pyetja *“po tani çdo bëjmë me çështjet?”* ishte e bërë e përditshme dhe e kudondodhur. Në praktikën gjyqësore të shkallës së parë dhe apelit, disa nga gjykatat pezulluan gjykimet, në mënyrë që të pritej publikimi i arsytuar i vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Disa nga gjykatat nuk e pezulluan gjykimin, e vazhduan dhe e përfunduan atë. Ato dhanë vendime përfundimtare dënimi me dispozitat që Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar që janë shfuqizuar. Argumenti ishte

¹⁷ Shiko edhe Vendimin nr. 13, datë 29.05.1997; Vendimin nr. 65, datë 10.12.1999; Vendimin nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Shiko në web: http://www.gjk.gov.al/web/NJOFTIM_P_R_MEDIAN_1106_1-94.php.

pikërisht dispozita e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese¹⁹, se vendimet hyjnë në fuqi si rregull në momentin kur botohen në Fletoren Zyrtare²⁰. Të tjerë gjyqtarë dhe gjykata shtynin seancat gjyqësore me shkaqe të stisura, edhe në fazën e konkluzioneve përfundimtare, me shpresën se vendimin Gjykata Kushtetuese, duke patur rëndësinë e veçantë të tij, do t'a publikonte shpejt.²¹ Megjithatë, pavarësisht zhurmës që bëhej poshtë, Gjykata Kushtetuese e publikoi vendimin në faqen zyrtare të internetit të saj në datë 26.02.2016, pas gati dhjetë muajsh nga paraqitja e kërkesës. Akoma vendimi nuk ishte publikuar në Fletoren Zyrtare dhe pika e fundit e dispozitivit të tij parashikonte se, vendimi hyn në fuqi në momentin e botimit të Fletoren Zyrtare. Vendimi Nr. 9, dt. 26.02.2016 i Gjykatës Kushtetuese rezulton të jetë botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 31, dt. 29.02.2016.²² Për rrjedhojë, konkludohet se vendimi ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2016. Megjithëse, të gjithë po prisnin se çfarë ka argumentuar Gjykata Kushtetuese, paqartësitë në praktikën gjyqësore nuk u zbehën, por u shtuan pas publikimit të vendimit në faqen e internetit dhe Fletoren Zyrtare. Afërmendsh, ky debat nuk zhvillohej vetëm nëpër gjykata, por me të njëjtin intensitet zhvillohej edhe në prokurori apo edhe avokati. Afërmendsh, kishte çështje në gjykim, ashtu sikurse kishte çështje edhe nën hetim me objekt procedimi figurat e veprave penale të parashikuara në paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, që tashmë nuk ishin më.

Dilema e Parë

Nuk kam dijeni nëse ndonjë prokurori apo gjykatë ka vendosur pushimin e gjykimit për shkakun se ligji nuk e parashikon më mbajtjen e armëve, minave, bombave apo lëndëve plasëse në makinë apo ambjente publike, pa lejen e organeve kompetente apo sipas paragrafit të fundit të shfuqizuar. Ndoshta, edhe mundet të ketë patur, apo mundet të ketë vendime të tilla. Por, me siguri di që të gjithë praktikantët e së drejtës në gjykata, prokurori dhe avokati janë rrekur për t'a zgjidhur çështjen e shtruar në hetim apo gjykim në këtë mënyrë. Edhe nëse nuk e kanë bërë, zgjidhja parimore në diskutimet me to ka qenë pikërisht kjo – “*nullum crimen sine legge*”. Në fakt, kjo është zgjidhja që në emërues të përbashkët bashkon çdo praktikant të së drejtës, pasi është e qartë sot se nuk ka ligj që të specifikojë të dënueshme figurat e veprave penale të parashikuara nga paragrafët e shfuqizuar të nenit 278 të Kodit Penal. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar të dy paragrafët tërësisht, duke lënë një boshësi të ndjeshme parashikimi ligjor penal material.

Paradoksi i ndodhur me këtë vendim dhe kontradikta më e pashpjegueshme është fakti që, të gjitha argumentet e konkluduara dhe artikuluara në lidhje me antikushtetutshmërinë e paragrafëve të shfuqizuar kufizohen dhe përqëndrohen tek sanksioni joproporcional i tyre dhe ndërkohë, shfuqizohen të gjitha figurat e veprës penale të parashikuara nga ato paragrafë. Kjo mënyrë disponimi e Gjykatës Kushtetuese nuk ka lidhje logjike me pjesën arsyetuese dhe i shkon

¹⁹ http://www.gjk.gov.al/web/ligji_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_gjykates_kushtetues_82.pdf.

²⁰ Shiko nenin 76 pika 1 të Ligjit Nr. 8577, dt. 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Këtë praktikë gjyqësore e kam konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

²¹ Këtë praktikë e kam konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

²² Shiko faqen 2492 e vijues të Fletores Zyrtare Nr. 31. Dt. 29.02.2016.

Në ëeb shiko: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/31-2016.pdf.

kundër logjikës së argumentuar tradicionalisht në jurisprudencën e vetë kësaj gjykate për koherencë logjike në të gjithë pjesët e vendimit²³.

Kështu, po të lexohet pjesa arsyetuese, atëherë, pa qenë e nevojshme të lexohet dispozitivi i vendimit, kuptohet se është shfuqizuar në secilin paragraf vetëm sanksioni joproporcional. Ky është dispozitivi afërmendsh i hamendësueshëm sakaq. Ndërkohë, po të lexosh vetëm dispozitivin, pa lexuar më parë pjesën arsyetuese, krijohet ideja se detyrimisht në pjesën arsyetuese është konkluduar se të gjitha figurat e veprave penale të parashikuara në dy paragrafët e shfuqizuar janë konstatuar se janë antikushtetuese.

Por, në të vërtetë, nuk është as njëra e as tjetra. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht kontradiktës së theksuar ndërmjet dispozitivit dhe pjesës arsyetuese, nga një anë individualizon dhe përqëndron të gjitha argumentet e antikushtetutshmërisë në pjesën e dënimit penal të artikuluar si sanksion në dy paragrafët e shfuqizuar dhe nga ana tjetër shfuqizon të dy paragrafët tërësisht. Kjo do të thotë se, bashkë me sanksionin janë shfuqizuar edhe pjesët e normës që parashikonin si figura të veprës penale armëmbajtjen pa leje, mbajtjen e bombave, minave dhe lëndëve plasëse pa leje dhe paragrafin e fundit dhe më të rëndin në rrethana cilësuese, atë të kryerjes së këtyre figurave të veprës penale në elemente cilësues dhe të rënduar. Mbetet e panjohur arsyeja se pse Gjykata Kushtetuese e vitit 2016 nuk iu përmbajt modelit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 1997²⁴ në mënyrën se si prek dhe heq nga rendi juridik normat penale ekcesive në raport me Kushtetutën.

Duke vendosur në të tillë mënyrë, Gjykata Kushtetuese ka tejçuar mesazhin tek publiku dhe praktikantët e së drejtës se janë shfuqizuar figurat e veprave penale dhe jo vetëm sanksioni i tyre. Ndaj, ky gabim nuk duhet të ishte bërë. Gjykata Kushtetuese duhet të kishte shfuqizuar në nenin 278 të Kodit Penal vetëm togfjalëshin e paragrafëve, që parashikonin sanksionet joproporcionale dhe si të tilla jokushtetuese dhe jo pjesën e normave hipotezë, apo pjesën narrative të tyre. Kjo formë dispozitivi nuk do të kishte lejuar krijimin e asnjë ekuivoku në praktikën gjyqësore dhe tek publiku i gjërë, pasi të gjithë do të kishin të qartë se Gjykata Kushtetuese dhe Vendimi 9/2016 nuk ka shfuqizuar figurat e veprës penale si antikushtetuese, por ka shfuqizuar sanksionet respektive jokushtetuese të tyre.

Kjo mënyrë disponimi dhe jo arsyetimi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese favorizon argumentat e tezës së dekriminalizimit të figurave të veprës penale të paragrafëve të shfuqizuar.

Dilema e Dytë

Gjatë kësaj kohe, gjykatat që kishin pezulluar gjykimin revokuan vendimin e ndërmjetëm të pezullimit. Bashkë me gjykatat që e kishin shtyrë disa herë gjykimin, në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ato dhanë zgjidhje të ndryshme në vendimet përfundimtare të dënimit.

Disa nga gjykatat vendosën deklarinimin fajtor të të pandehurit, sipas paragrafit të dytë të nenit 278 të Kodit Penal, sikur ka qenë para ndryshimeve të vitit 2013.²⁵ Këto gjykata kanë dhënë vendime dënimi duke zbatuar paragrafin që formulohej: “*Mbajtja, e armëve, bombave apo minave lëndët plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.*”. Sipas kësaj praktike, shfuqizimi i paragrafit të pestë dhe të gjashtë të

²³ Shiko Vendimin nr.8, datë 16.03.2011; Vendimin nr. 23, datë 04.11.2008; Vendimin nr. 11, datë 02.04.2008; Vendimin nr.7, datë 09.03.2009; Vendimin. 52, dt. 02.12.2013; Vendimin Nr. 51, dt. 12.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese. të Gjykatës Kushtetuese.

²⁴ Shiko Vendimin Nr.13, datë 29.5.1997 të Gjykatës Kushtetuese.

²⁵ Kjo praktikë gjyqësore është konstatuar nga disa gjyqtarë dhe trupa gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

nenit 278 të Kodit Penal kthejnë në fuqi ligjin e shfuqizuar nga ky ligj i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese si antikushtetues.

Në këtë mënyrë, kjo praktikë gjyqësore argumenton se, duke u shfuqizuar dispozita e ndryshuar, automatikisht shfuqizohet edhe dispozita që ka shfuqizuar dispozitën e mëparshme. Në këtë mënyrë, në fuqi mbetet dispozita e shfuqizuar, sikur të mos ishte shfuqizuar kurrë, dhe në bazë të saj do të kualifikohen juridikisht edhe figurat e veprave penale që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin 9/2016.²⁶

Dilema e Tretë

Ndërkohë, disa gjyqtarë të tjerë dhe trupa gjyqësore të tjera²⁷ kanë dhënë vendime përfundimtare dënimi sipas paragrafit të tretë të nenit 278 të Kodit Penal. Përgjithësisht, ky qëndrim është mbajtur edhe nga organi i akuzës.²⁸ Kështu, sipas këtij qëndrimi, për figurat e veprës penale të mbajtjes së armëve, bombave, lëndëve plasëse dhe minave dhe për figurat e veprës penale të parashikuara nga paragrafi i gjashtë i shfuqizuar tashmë, do të kualifikohen ligjërisht sipas paragrafit të tretë të nenit 278 të Kodit Penal, të formuluar sipas ndryshimeve të vitit 2013 – nga harku kohor kur kanë hyrë këto ndryshime në fuqi dhe deri në hyrjen në fuqi të ndryshimeve të vitit 2014. Paragrafi i individualizuar, sipas kësaj mënyre formulon se: *“Mbajtja e armëve, i bombave apo minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”* Ndërkohë, për të gjitha figurat e veprës penale të lartpërmendura, që kanë ngjarë nga hyrja në fuqi e ndryshimeve të vitit 2014 e deri më tani, do të kualifikohen ligjërisht sipas paragrafit të tretë dhe të katërt, që disponojnë se: *“Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.”* Më tej, për veprat penale të ngjara pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të vitit 2015, ligjërisht do të kualifikohen sipas paragrafit të pesë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal.

Sipas kësaj praktike gjyqësore, në thelbin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, veç shfuqizimit të dy paragrafëve, për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit në artikullimin e sanksioneve penale, ka argumentuar se figurat e veprës penale të armëmbajtjes, minëmbajtjes, mbajtjes së lëndëve plasëse apo mbajtjes së bombave, nuk mundet të kenë si element të cilësuar vendin ku kryhet vepra. Në këtë mënyrë, kjo praktikë gjyqësore dhe kjo mënyrë interpretimi e organit të akuzës konkludon se, në fakt, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar në mënyrë të heshtur, bashkë me paragrafët e shfuqizuar, edhe fjalën *“banesë”* nga paragrafët respektiv të mbetur të dispozitës e bashkë me të edhe elementin cilësues të vendit të kryerjes së veprës penale. Në këtë mënyrë, vijojnë ato, këto dy paragrafë të mbetur të nenit 278 të Kodit Penal do të zbatohen universalisht për mbajtjen e armëve, minave, bombave apo lëndëve plasëse

²⁶ Kjo mënyrë interpretimi e ligjit, e shfuqizimit të tij nga Gjykata Kushtetuese dhe përtëritja e ligjit të shfuqizuar më parë të sjell në vëmendje nenin 127 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili nën titullin *“Revokimi/shfuqizimi që përtërin fuqinë ligjore të një akti të mëparshëm”* disponon se: *“Revokimi ose shfuqizimi i një akti, i cili nga ana e tij ka revokuar/shfuqizuar një akt të mëparshëm, përtërin fuqinë ligjore të këtij të fundit vetëm në rastet kur ligji ose akti i fundit revokues/shfuqizues e parashikojnë shprehimisht një gjë të tillë.”*

²⁷ Sërisht kjo praktikë është konstatuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë.

²⁸ Kjo praktikë është konstatuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe duke patur parasysh se, sipas nenit 148 të Kushtetutës, prokuroria funksionon si organ kushtetues i centralizuar, afërmendsh mendoj se ky qëndrim do të jetë mbajtur në të gjithë territorin nga organi i akuzës.

pa lejen e organeve kompetente, duke mos e patur më në përbërje si element cilësues të dispozitës dhe figurës së veprës penale vendin banesë, automjet apo vende publike.

Nga ana tjetër, ka edhe gjyqtarë dhe trupa gjyqese që përkrahin këtë praktikë gjyqësore, por me arsyetim tjetër, duke argumentuar se nuk mundet të pretendohet se figurat e veprave penale që parashikoheshin nga paragrafet e shfuqizuara të nenit 278 të Kodit Penal nuk janë më të dënueshme penalisht. Duke qenë të dënueshme penalisht, ky qëndrim konkludon se, e vetmja mënyrë për të kualifikuar këto veprime të paligjshme është që, kualifikimi juridik i tyre të bëhet sipas paragrafëve të mbetur të dispozitës për mbajtjen pa leje të këtyre sendeve në banesë. Për rrjedhojë, vendimet përfundimtare sipas kësaj praktike gjyqësore dënojnë subjektet e procedimit penal sipas këtij kualifikimi juridik. Interpretimi në këtë rast, duke nisur me logjikën e përjashtimit, mbyllet nën një logjikë kualifikimi me karakter mbetës.

Dilema e Katërt

Tej këtyre diskutimeve dhe praktikave gjyqësore të ndryshme, si në qëndrime dhe në argumentime, ka edhe një autoritet gjyqësor tjetër që ka shtruar për diskutim dilemat kushtetuese që mbart Vendimi 9/2016 i Gjykatës Kushtetuese. Kësaj rradhe bëhet fjalë për autoritetin më të lartë gjyqësor në Republikën tonë, konkretisht Gjykatën e Lartë. Kështu Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të një rekursi drejtuar një vendimi të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka pezulluar gjykimin dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Në Vendimin e datës 10.03.2016 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka disponuar: *“Pezullimin e gjykimin të çështjes. -T’i paraqesë kërkesën Gjykatës Kushtetuese për: 1) Interpretimin e Vendimit nr. nr. 9 datë 26.02.2016, (V-9/16), botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31-2016, datë 29.02.2016, i cili ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr. 144/2013, si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014”, dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. 2) Plotësimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për të njëjtat shkaqe të deklaruara në vendimin e saj, duke deklaruar edhe paligjshmërinë kushtetuese të nenit 1 të ligjit 135/2015, që ka ndryshuar nenin 55 të Kodit Penal, si edhe duke marrë shkas nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 135/2015, që ka shtuar dy paragrafë pas paragrafit të parë, korigjimin e paragrafëve objekt të shfuqizimit të vendimit, duke i konsideruar në dispozitivin e vendimit si paragrafin e “shtatë” dhe të “tetë” të Kodit Penal, dhe shfuqizuar paragrafin e 7 (shtatë) dhe 8 (tetë) të nenit 278 të Kodit Penal të ndryshuar me nenin 17 të ligjit nr. 135/2015.”.*

Për qëllimet që ky shkrim i ka vënë vetes që në krye, do të përqëndrohem vetëm në dilemat kushtetuese që ka shtruar për zgjidhje Vendimi 9/2016 i Gjykatës Kushtetuese në praktikën gjyqësore lidhur me figurat e veprave penale të parashikuara nga paragrafët e shfuqizuara të nenit 278 të Kodit Penal.

Kështu Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë u shpreh se: *“Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e Këshillimit vlerëson se Vendimi nr. 9, datë 26.02.2016, i Gjykatës Kushtetuese paraqet dyshime lidhur mbi interpretimin, kuptimin dhe shtrirjes së efekteve dhe objektit të tij, duke u kuptuar dhe interpretuar në mënyrë të cilat për nga efektet, rrjedhojat, shtrirja e tyre, paraqiten krejtësisht të ndryshme dhe me pasoja të konsiderueshme për sistemin juridik shqiptar dhe veçanërisht të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjithashtu, për shkak të ndërhyrjes së ligjvënësit në periudhën kohore mbas shqyrtimit të çështjes, por par zbardhjes së*

saj, ka miratuar ndryshime që kanë të bëjnë me lëndën, e cila ka përbërë objekt kushtetutshmërie është e nevojshme dhe plotësimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese.”.

Dilemat e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë artikulojnë në vendim si më poshtë: “Sikundër mund të konstatohet, ky interpretim i tekstit në fuqi të nenit 278 të Kodit Penal, pa përfshirë, paragrafin “5” dhe “6” të deklaruar si antikushtetues, duke qenë se objekt i kërkesës, gjykimit, dhe dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese ka qenë, jo i gjithë neni 43, i ligjit nr. 144/2013, dhe jo i gjithë neni 5 i ligjit nr. 98/2014, por vetëm ajo pjesë të atij, që ndryshon dhe disponon vetën formulimin e paragrafit “5” dhe “6”, ndërsa pjesa tjetër e nenit 43, të ligjit nr. 144/2013, ajo e nenit 5 të ligjit nr. 98/2014, rezultojnë se janë në pajtim me Kushtetutën dhe janë reflektuar në shtesat dhe ndryshimet e pjesëve të tjera të nenit 278 të Kodit Penal, të cilat prodhojnë efekte dhe vazhdojnë të mbeten në fuqi. Domethënë, duke qenë se objekti i gjykimit kushtetues nuk ka qenë akti ndryshues në tërësi, por akti i ndryshuar vetëm në disa efektet të tij (ato që përmbahen në paragrafin e pestë dhe gjashtë), disa efekte të tjera të aktit ndryshues janë prodhuar dhe gjejnë zbatim ende në tekstin aktual të dispozitës së nenit 278 të Kodit Penal.

Në rastin konkret, duke qenë se neni 43 i ligjit nr. 144/2013, jo vetëm që ka parashikuar mbajtjen e armës pa leje si rrethanë të posaçme për cilësimin e veprës penale si paragraf më vete, duke e parashikuar në rrethana në mjedise publike dhe në mjedise të hapura për publikun, si paragrafin 4 (katër), nga ana tjetër, po i njëjti nen i ligjit ndryshues, e ka hequr figurën e “mbajtjes pa leje të armës” nga parashikimi i paragrafit të dytë, i cili kriminalizon vetëm mbajtjen e municionit luftarak, jo të armës, dhe ky efekt i nenit 278 të Kodit Penal, duke qenë se nuk është shfuqizuar krejtësisht neni 43 i ligjit nr. 144/2013, rezulton të jetë në fuqi dhe nuk është bërë objekt i dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, edhe efektet e nenit 5 të ligjit nr. 98/2014, duke qenë se nuk është shfuqizuar krejtësisht ky nen, vazhdojnë të mbeten në fuqi, duke parashikuar kriminalizimin e mbajtjes pa leje të armës vetëm në banesë, sipas paragrafit “3” të nenit 278 të Kodit Penal.

Në këtë aspekt, nga analiza e nenit 278 të Kodit Penal pas shtrirjes së efekteve shfuqizuese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji Penal vëren se çështja e “mbajtjes së armës pa leje në ambiente të ndryshme nga banesa”, si rezultat i prodhimit të efekteve të Vendimit nr. 09, datë 26.02.2016, të Gjykatës Kushtetuese, rezulton të mbetet e paparashikuar nga ligji si vepër penale, për shkak se një pjesë e efekteve të nenit ndryshues janë lënë jashtë deklarimit të paligjshmërisë kushtetuese. E thënë ndryshe, rezulton sipas paragrafit “3” të nenit 278 të Kodit Penal, se inkriminimi i veprës penale të “mbajtjes pa leje të armës” është i parashikuar shprehimisht vetëm në rastin kur kjo hipotezë ndodh në ambientet e banesës. Ndërsa në rastet e ambienteve të tjera, të hapura, apo vende publike, për efekt të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ajo nuk përbën më një vepër penale, pasi nuk rezulton të jetë e parashikuar e shprehur si hipotezë inkriminuese në tekstin e dispozitës të nenit 287 të Kodit Penal, duke qenë se nga pikëpamja ligjore efekti i heqjes së armëmbajtjes pa leje në paragrafin e dytë sipas versionit të vitit 2001, nga neni 43 të ligjit nr. 144/2013, rezulton të jetë në fuqi. Pra, efektet e ndërhyrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese për armëmbajtjen pa leje në ambiente të ndryshme nga ai i banesës, sipas këtij këndvështrimi do të konsideroheshin si një dekriminalizim, domethënë një shfuqizim të veprës penale të mbajtjes pa leje të armës së kryer në ambiente publike apo të hapura ndaj publikut, sipas të gjitha rrjedhëve që do të mund të lindnin për të gjitha çështjet në hetim, gjykim, por edhe ato në ekzekutim e sipër, që janë kryer ose do të kryen në të ardhmen, përkatësisht në lidhje me rrethanën e cilësimit të vendit të mbajtjes së armës: në banesë (akoma e ndëshkueshme sipas efekteve të nenit 43 të ligjit nr. 144/2013), apo në vende publike apo të

hapura ndaj publikut, (sipas këtij këndvështrimi) e pandëshkueshme në bazë të shfuqizimit të paragrafit të “5”.

Kështu Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludonte se shfuqizimi i dy paragrafëve të nenit 278 të Kodit Penal, në mungesë të sqarimeve të mëtejshme të Gjykatës Kushtetuese dhe në prezencën e një vendimi të paqartë, i ka depenalizuar figurat e veprave penale që këto paragrafë të shfuqizuar tashmë parashikonin deri para shfuqizimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë u argumentua se: *“Nga ana tjetër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vëren se, objekti dhe efektet e Vendimit nr. 9, datë 26.02.2016, të Gjykatës Kushtetuese mund të kuptohen dhe interpretohen edhe në një mënyrë tjetër, e cila është e papajtueshme dhe nuk mund të konkurrojë me kuptimin dhe interpretimin e tjetër të parashtruar më lart. Po të konsiderohet se objekti gjykimit dhe shtrirja e efekteve të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk duhet të konsiderohet, akti i ndryshuar, domethënë neni 278 i Kodit Penal, por akti ndryshues, domethënë përkatësisht, shfuqizimi ‘tërësor’ i nenit 43, të ligjit nr. 144/2013, dhe shfuqizimi ‘tërësor’ i nenit 5 të ligjit nr. 98/2014. Në këto kushte, duke mos mbetur asnjë efektet i ligjit ndryshues në fuqi, nuk do të kishte asnjë pengesë në mbetjen në fuqi të nenit 278, përpara reformës së vitit 2013 dhe asaj të vitit 2014.*

Sipas këtij këndvështrimi, qëllimi dhe objekti i kërkesës për kushtetutshmërinë e paragrafit “5” dhe “6” të nenit 278 të Kodit Penal, nuk ka qenë deklarimi i si jo kushtetues i “disa” efekteve të që ka pësuar neni 278 i Kodit Penal, por vlerësimi në tërësi i nenit 43, të ligjit nr. 144/2013, dhe shfuqizimi në tërësi i nenit 5 të ligjit nr. 98/2014, duke u deklaruar si jo kushtetues vetëm dallimi që bëhej nga dispozita lidhur me cilësimin e vendit të kryerjes së veprës penale, në banesë, në automjete apo në mjedise publike dhe në mjedise të hapura për publikun, dhe jo vepra në tërësi e mbajtjes pa leje të armës edhe jashtë banese. E thënë ndryshe, me deklarimin e paligjshmërisë kushtetuese të nenit 43, të ligjit nr. 144/2013, dhe të nenit 5 të ligjit nr. 98/2014, për shkak të shkeljes së parimit kushtetues të përpjesëtueshmërisë, ka rënë dallimi dhe cilësimi i rrethanës rënduese lidhur me llojin e vendit, dhe për rrjedhojë edhe parashikimi i masës së dënimit disproporcionale sipas mjediseve publike apo të hapura për publikun, të cilat nuk janë më të nevojshme për konfigurimin dhe cilësimin e veprës penale të mbajtjes së armës pa leje, duke u rikthyer kuadri ligjor në fuqi, përpara ndodhjes së ndryshimeve, përkatësisht sipas nenit 43, të ligjit nr. 144/2013, dhe nenit 5 të ligjit nr. 98/2014...”²⁹

Më tej Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë argumenton se vendimmarrja plotësuese dhe interpretuese e Gjykatës Kushtetuese në rastin konkret është e domosdoshme duke qenë se kemi të bëjmë me parimin e ligjshmërisë në të drejtën penale dhe se, në mënyrë që të mos ngjallet asnjë dyshim lidhur me përmbajtjen e saktë të vendimit që ka shfuqizuar dy paragrafët e nenit 278 të Kodit Penal, Gjykata Kushtetuese duhet të plotësojë vendimin e saj në pjesën e dispozitivit, duke saktësuar se paragrafët antikushtetues, pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 135/2015, janë në fakt, përkatësisht, paragrafi “7” dhe “8” i nenit 278 të Kodit Penal.

Zgjidhja Kushtetuese dhe Konventore

Në fakt, eliminimi i shfuqizimit të gabuar të Gjykatës Kushtetuese për të dy paragrafët e nenit 278 të Kodit Penal do të ishte vetëm zgjidhja e parë dhe e pjesshme, por jo e plota e problemit. Sipas çdo varianti shfuqizues, qoftë edhe vetëm të sanksionit penal, sërisht dispozita do të kishte probleme praktike zbatimi. Edhe sipas këtij varianti normal dhe me kuptim të shfuqizimit

²⁹ Shiko Vendimin Nr. 52909-00674-00-2015, Akti, Nr. 00-2016- i Vendimit (), dt. 10.03.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

kushtetues, debati do të ishte se kush do të ishin marzhet e sanksionit të dënimit penal për secilën prej figurave të veprës penale? Megjithatë ky variant shfuqizimi do të përjashtonte automatikisht idenë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka dekriminalizuar figurat e veprës penale të shfuqizuara në dy paragrafët e nenit 278 të Kodit Penal.

Megjithatë në këtë pjesë të shkrimit, më shumë se sa dua të merrem me çfarë ka ndodhur dua të përqëndrohem tek çështja se çfarë duhet të ndodhë dhe se si duhet të zgjidhen dilemat kushtetuese të shtruara në zbatimin praktik të Vendimit 9/2016 të Gjykatës Kushtetuese. Në rastin konkret i gjithë debati mbi paragrafët e figurave të veprave penale të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese ka të bëjë me kualifikimin juridik të tyre në praktikë, ndjekjen penale dhe dënimin më tej, sipas parimit *nullum crimen sine legge*. Dhe pyetja që shtrohet për zgjidhje është se: a do të ketë dënime penale për figurat e paragrafëve të shfuqizuara apo në të vërtetë ato nga shfuqizimi janë dekriminalizuar; dhe nëse do të dënohen subjektet autorë, si do të kualifikohen juridikisht figurat e veprave penale dhe kush do të jenë marzhet e sanksioneve të dënimit penal? Zgjidhja, si gjithnjë dhe e papërtueshme, në këtë boshësi ligjore të shkaktuar në ligjin material penal fillimisht vjen nga Kushtetuta dhe K.E.D.Nj.. Në mënyrë komplementare dhe më iluminuese edhe nga jurisprudenca Gj.E.D.Nj..

Sjell në vëmendje se Neni 29 i Kushtetutës disponon se: *“1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare. 2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. 3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.”*

Ndërkohë neni 7 i K.E.D.Nj., si motra e nenit 29 të Kushtetutës sonë, disponon se: *“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte veprë penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej veprë penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.”*

Ky parim është parashikuar në nenin 15 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike³⁰, në nenin 49 të Kartës për të Drejtat e Njeriut të Bashkimit Evropian, në nenin 22 dhe 24 të Statutit të Romës³¹.

Vlerësoj se premtimi kushtetues dhe konventor i parimit të mosdënimit pa ligj duhet të kuptohet si garanci e kujtdo ndaj ushtrimit të ndjekjes penale dhe ndaj dënimit penal në mënyrë arbitrare. Ky parim është element thelbësor i shtetit të së drejtës.³² Për rrjedhojë mosdënimi pa ligj do të thotë edhe ndalimi i zbatimit të ligjit penal me analogji dhe në mënyrë të zgjeruar, që dëmton në thelb dhe rëndon pozitën ligjore të të proceduarit penalisht. Për rrjedhojë lind detyrimi kushtetues dhe konventor i ligjvënësit për të parashikuar shprehimisht në ligj veprat penale dhe dënimet penale respektive. Për të patur një ligj penal kushtetues dhe konventor kualitativisht duhet që ai të kënaqë kërkesat për aksesueshmëri dhe parashikueshmëri nga subjektet të cilëve ai u

³⁰ Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike ka hyrë në fuqi më datë 23 mars 1976. Ai është miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe aderim nga asambleja e përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966.

³¹ Shiko Ligjin Nr. 8984, dt. 23.12.2002 *“Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatë Ndërkombëtare Penale”*. Shiko: http://www.pp.gov.al/web/statuti_i_romes_per_gjykatën_nderkombetare_penale_813.pdf

³² Shiko çështjen *“Contrada v. Italy (3)”*, Vendim i Seksionit IV i Gj.E.D.Nj. dt. 14.04.2015, Ap. No. 66655/2013.

kundrejtohet. Aksesueshmëria dhe parashikueshmëria e ligjit penal mundet të vlerësohet e plotësuar si standart kushtetues dhe konventor nëse subjektet kanë mundësi të kuptojnë hipotezën e normës penale, veprimin e ndaluar dhe pasojat përkatëse apo sanksionet penale. E nëse është e nevojshme duhet që subjektet ta kuptojnë normën ligjore penale, jo në bazë të aftësive të veta por edhe nëpërmjet ndihmës së të drejtës së gjallë, praktikës gjyqësore³³ dhe pas marrjes së një ndihme të përshtatshme ligjore, për të qenë të aftë sakaq të kuptojnë veprimet apo mosveprimet të cilat mundet të t'i kundrejtojnë dhe t'i aktivizojnë atyre përgjegjësinë penale.³⁴

Gj.E.D.Nj. ka njohur vazhdimisht kontributin e domosdoshëm dhe të nevojshëm të praktikës gjyqësore në interpretimin e ligjit penal, pasi gjithnjë do të ketë nevojë për sqarimin e çështjeve të dyshimta, të interpretueshme dhe të adaptueshme në rrethana sociale që ndryshojnë vazhdimisht, por interpretimi i ligjit edhe nga gjykata nuk mundet të jetë i tillë sa të krijojë një normë apo rregull, që ndëshkon penalisht në mënyrë të njëjtë sikurse të ishte ligj. Kështu, sikurse neni 7 i K.E.D.Nj., edhe neni 29 i Kushtetutës sonë nuk mundet të interpretohet në mënyrë të tillë që të përjashtojë praktikën gjyqësore apo vetë jurisprudencën nga zhvillimi i ligjit penal nga çështja në çështje, gjithnjë duke patur parasysh që edhe e drejta e gjallë duhet të gëzojë në vetvete legjitimitetin kualitativ në elementet e aksesueshmërisë dhe parashikueshmërisë së saj.³⁵ Për më tepër që është në misionin kushtetues dhe konventor vetëm të gjykatave të juridiksionit gjyqësor detyra për të kualifikuar juridikisht një fakt penal të caktuar të sjellë për gjykim nga organi i akuzës.³⁶

Kjo mënyrë nëpërmjet së cilës duhet të formësohet ligji penal nuk përjashton apriori mundësinë që ligji penal të mos jetë preçiz. Pikërisht mundësi të tilla formulimi të ligjit penal, të shkaktuara si pasojë e shkaqeve objektive dhe subjektive të procesit ligjvënës apo pse jo edhe pas ndërhyrjeve shfuqizuese të Gjykatës Kushtetuese, evokojnë nevojën për elaborimin e tij nga praktika gjyqësore dhe jurisprudenca, qoftë për interpretimin e zgjeruar apo të ngushtuar të tij³⁷. Gj.E.D.Nj. ka pranuar se në çdo sistem të së drejtës, sado që i qartë të jetë draftuar ligji penal, ka nevojë për qartësimin e tij nëpërmjet interpretimit gjyqësor, pasi gjithnjë do të ketë nevojë për iluminim të shumë çështjeve të diskutueshme dhe për përshtatje të ligjit me rrethanat që ndryshojnë si në kohë dhe në hapësirë.³⁸ I mbetet pikërisht interpretimit gjyqësor të përshtasë

³³ Shiko çështjen “*Cantoni v. France*”, Vendim i Gj.E.D.Nj. 15.11.1996, paragrafi 29, Reports of Judgments and Decisions 1996-V; çështjen “*Cowme and Others v. Belgium*”, Ap. nos. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, paragrafi 145, Vendim i Gj.E.D.Nj., ECHR 2000-VII; çështjen “*Sud Fondi S.r.l. and Others v. Italy*”, Ap. no. 75909/01, paragrafi 107 dhe 108, Vendim i Gj.E.D.Nj. dt. 20.01.2009; dhe çështjen “*Ashlarba v. Georgia*” A. No. 45554/08, Vendim i Seksionit IV të Gj.E.D.Nj. dt. 15.07.2014.

³⁴ Shiko çështjen “*Del Río Prada v. Spain*”, Vendim i Dhomës së Madhe të Gj.E.D.Nj., Ap. no. [42750/09](#), shiko paragrafët 77-80 dhe 91, viti 2013; çështjen “*S.Ë. v. the United Kingdom*”, Vendim i Gj.E.D.Nj. dt. 22.11.1995, paragrafët 34-35, Series A no. 335-B; çështjen “*C.R. v. the United Kingdom*”, Vendim i dt. 22.11.1995, paragrafët 32-33, Series A no. 335-C).

³⁵ Shiko çështjen “*Dallas v. The United Kingdom*”, Ap. No. [38395/12](#), Vendim dt. 11.02.2016 i Seksionit I të Gj.E.D.Nj., shiko paragrafin 70 që referon edhe në çështjen “*Del Río Prada vs. Spain*”.

³⁶ Shiko çështjen “*Rohlena v. the Czech Republic*”, Vendim i Dhomës së Madhe, Ap. no. [59552/08](#), paragrafi 51, ECHR 2015.

³⁷ Shiko paragrafin 34 të çështjes “*Ashlarba v. Georgia*” A. No. 45554/08, Vendim i Seksionit IV të Gj.E.D.Nj. dt. 15.07.2014.

³⁸ Florjan Kalaja, “Dilema Kushtetuese I”, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Janar 2016. Shiko Kreun IV të titulluar “Arsyetim paralel i pakicës në Vendimin Unifikues Penal 2/2014”.

normën penale në kohë përgjatë zhvillimit shoqëror dhe rrethanave të reja të panjohura më pare në momentin kur norma ligjore u hartua.³⁹

Kufiri i shkeljes së parimit të përbotshtëm të “*nullum crimen sine legge*” për ligjin në kuptimin formal dhe ligjin në kuptimin material apo të drejtën gjyqësore do të jetë gjithmonë ndalimi i arbitraritetit në ndjekjen penale dhe në dënim⁴⁰. Kështu nuk mundet që ligji penal të zbatohet dhe të interpretohet në një mënyrë të papritur arsyeshëm nga kushdo të cilëve ai u kundrejtohet, e për më tepër në disfavorin e tyre.⁴¹ Për rrjedhojë ligjit penal dhe të drejtës gjyqësore në çdo rast, pavarësisht mënyrës së zbatimit apo interpretimit, i duhet të gëzojë aksesueshmërinë dhe parashikueshmërinë e arsyeshme nga kushdo human me inteligjencë mesatare dhe në mirëbesim. Kështu prishmëria e arsyeshme e kujtdo subjekti, se veprimet apo mosveprimet mundet të aktivizojnë përgjegjësinë penale sipas ligjit formal dhe ligjit të zhvilluar sipas së drejtës së gjallë, do të mundet të justifikojë zhvillimin e ligjit dhe një norme të tillë nga praktika gjyqësore *pro futuro*. Pikërisht zhvillimi i tillë i legjislationit dhe i së drejtës është një meritë dhe atribut pikërisht e jurisprudencës në përgjithësi.

Nën këtë filozofi të konceptimit dhe të zbatimit të nenit 7 të K.E.D.Nj. dhe parimit të përbotshtëm të mosdënimit pa ligj, Gj.E.D.Nj. ka gjetur të pabazuara pretendimet e znj. Dallas për cenimin e parimit *nullum crimen sine legge*, çështje në të cilën gjykata angleze e dënoi atë për veprën penale të mosbindje ndaj gjykatës. E gjykuara në këtë rast kishte qenë në cilësinë e anëtarit të jurisë dhe në kundërshtim me urdhërin e gjyqtarit kishte përdorur internetin për të parë historinë e mëparshme kriminale të të pandehurit që po gjykohej në atë gjyq. Gj.E.D.Nj. vlerësoi se në rastin konkret për të gjykuarën ka qenë e qartë se, veprimi që ajo kreu ishte në kundërshtim me urdhërat e gjykatës të dhëna verbalisht në seancë dhe pavarësisht kësaj ndërgjegjeje ajo veproi në kundërshtim me të. Gj.E.D.Nj. vlerësoi se në rastin konkret interpretimi gjyqësor i veprës penale të mosbindjes së gjykatës nuk është i papritur dhe nuk është as arbitrar. Gj.E.D.Nj. vlerësoi se në rastin konkret interpretimi që gjykata angleze i bëri veprës penale ishte i aksesueshëm dhe i parashikueshëm dhe se roli ligjbërës i gjykatës në rastin konkret mbeti në kufijtë e të arsyeshmes, pasi ky vendim gjyqësor mundet të konsiderohet si një hap i mëtejshëm i qartësimit të normës penale nga jurisprudenca.⁴²

Gjithashtu Gj.E.D.Nj. nuk ka gjetur shkelje të parimit *nullum crimen sine legge* edhe në çështjen *Martirosyan v. Armenia*.⁴³ Ankuesi në këtë rast ishte akuzuar dhe dënuar se kishte falsifikuar disa dokumenta të bankës ku punonte të cilat pasqyronin llogari dhe bilance. I proceduari u akuzua për shpërdorim detyre dhe falsifikim të dokumentave, ndër të tjera edhe sipas nenit 187 të Kodit Penal të vitit 1961, i cili veproi deri në datë 01.08.2003 kur hyri në fuqi Kodi Penal i ri.⁴⁴ Kjo dispozitë, e cila ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ishte konceptuar në kohën kur prona ishte ekskluzivisht shtetërore dhe nuk njihej sipërmarrja e lirë, duke patur parasysh se Bashkimi Sovjetik në këtë kohë kishte regjimin komunist dhe etatist të ekonomisë. Për rrjedhojë dispozita parashikonte se dënonte vetëm falsifikimin e dokumentave zyrtar shtetëror dhe nuk parashikonte si figurë vepre penale edhe falsifikimin e dokumentave privat.

³⁹Shiko çështjen “*Achour v. France*”, Vendim i Dhomës së Madhe dt. 29.03.2006, Ap. no. 67335/01, paragrafi 54, ECHR 2006-IV.

⁴⁰ Shiko çështjen “*Scoppola v. Italy (no. 2)*”, Vendim i Dhomës së Madhe dt. 17.09.2009, Ap. no. [10249/03](#), shiko paragrafin 92 të vendimit.

⁴¹ Shiko çështjen “*Huhtamäki v. Finland*”, Ap. no. 54468/09, paragrafi 41, Vendim i Gj.E.D.Nj. dt. 06.03.2012.

⁴² Shiko çështjen “*Dallas v. The United Kingdom*”, Ap. No. [38395/12](#), Vendim dt. 11.02.2016 i Seksionit I të Gj.E.D.Nj. paragrafi 77 i vendimit.

⁴³ Shiko çështjen “*Martirosyan v. Armenia*”, Ap. no. [23341/06](#), Vendim i Seksionit III të Gj.E.D.Nj. dt. 05.02.2013.

⁴⁴ Ky Kod ishte në fuqi në kohën kur Armenia ishte pjesë e Bashkimit Sovjetik.

Ndërkohë Kodi Penal i ri, që hyri në fuqi me datë 01.08.2003, parashikoi se falsifikimi i çdo dokumenti përbënte vepër penale. Pas shpalljes së pavarësisë së Armenisë dhe ndryshimit të regjimit ekonomik në atë kapitalist, u njoh edhe prona private dhe sipërmarrja e lirë ekonomike. I proceduari, gjatë kohës së ndodhjes së faktit penal, punonte si përgjegjës në një nga bankat private dhe, duke shpërdoruar detyrën, kishte përvetësuar nëpërmjet falsifikimit të dokumentave bankare shuma të konsiderueshme parash.

Ankuesi para Gj.E.D.Nj. ndër të tjera pretendoi se, zbatimi me analogji dhe në mënyrë të zgjeruar i Kodit Penal të vitit 1966 në rastin e tij, përbën shkelje të nenit 7 të K.E.D.Nj., pasi në të vërtetë ai ishte dënuar me norma penale, që si element cilësues kishin kryerjen e tyre në organet shtetërore apo organizata të tjera shtetërore dhe jo persona juridik privat.⁴⁵ Ai solli në vëmendje se, sipas legjislacionit dhe kuadrit kushtetues në të cilin është miratuar Kodi Penal i vitit 1966, personat juridik privat nuk njiheshin dhe ishin të ndaluar. Ai pretendoi se, në këtë mënyrë, duke u zbatuar ligji penal me interpretim të zgjeruar dhe me analogji, ndjekja penale dhe dënimi kanë qenë pa ligj dhe arbitrare. Shteti Armen pretendoi se në rastin konkret interpretimi gjyqësor përmbush edhe kushtin cilësor të parashikueshmërisë edhe atë të aksesueshmërisë dhe për rrjedhojë nuk ka shkelje.

Gj.E.D.Nj., pasi theksoi edhe një herë filozofinë e jurisprudencës së saj tradicionale mbi nenin 7 të K.E.D.Nj., theksoi se zhvillimi progresiv i së drejtës penale nëpërmjet ligj-bërjes gjyqësore⁴⁶ është një fenomen i nevojshëm dhe i bërë traditë tashmë nga rendet juridike evropiane dhe e pranuar nga K.E.D.Nj..⁴⁷ Gj.E.D.Nj. vlerësoi se interpretimi i zgjeruar dhe i përshtatur i Kodit Penal të vitit 1966 sipas rendit të ri ekonomik dhe kushtetues të sipërmarrjes së lirë nga gjykatat armene, nuk përbënte zbatim të ligjit me analogji, ashtu sikurse nuk përbënte një zbatim arbitrar të ndjekjes dhe dënimit penal në kundërshtim me parimit *nullum crimen sine lege*. Gj.E.D.Nj. vlerësoi se ankuesi i dënuar mundej ta parashikonte dhe të kishte akes në ligjin penal, aq sa për të kuptuar se falsifikimi i dookumentave të bankës dhe shtënia në dorë e pasurisë nëpërmjet tyre është vepër penale dhe si e tillë dënohet penalisht. Për rrjedhojë Gj.E.D.Nj. vlerësoi unanimisht se në këtë rast nuk ka patur asnjë shkelje të nenit 7 të K.E.D.Nj. dhe të parimit *nullum crimen sine lege*.

Në momentin kur rezulton të jetë qartësuar jurisprudenca e Gj.E.D.Nj. në zbatim të nenit 7 të K.E.D.Nj., mbetet të analizohen dhe adresohen zgjidhje për dilemat e parashtruara më lart. Ajo çka duhet të theksohet është që, në bazë dhe për zbatim të nenit 17 të Kushtetutës, do të duhet që, edhe neni 29 i Kushtetutës të zbatohet dhe interpretohet sipas filozofisë së Gj.E.D.Nj., pavarësisht se praktika jonë kushtetuese dhe doktrina e së drejtës penale është e pazhvilluar në këtë drejtim dhe njëkohësisht e ngurtë.

Vlerësoj se, pavarësisht se Gjykata Kushtetuese në Vendimin 9/2016 ka gabuar kur ka shfuqizuar të dy paragrafët tërësisht të nenit 278 të Kodit Penal, në një kohë ku sipas arsytimit të vendimit do të duhet të shfuqizoheshin vetëm pjesët respektive të sanksionit, figurat e veprave penale të parashikuara në paragrafët e shfuqizuar nuk janë dekriminalizuar nga vendimi shfuqizues. Vlerësoj se këtyre figurave të veprës penale, të gjithave njëjloj u është shfuqizuar vetëm sanksioni. Paragrafët ekzistues të nenit 278 të Kodit Penal parashikojnë se armëmbajtja pa leje,

⁴⁵ Shiko paragrafin 50 në çështjen “*Martirosyan v. Armenia*”, Ap. no. [23341/06](#), Vendim i Seksionit III të Gj.E.D.Nj. dt. 05.02.2013.

⁴⁶ Shiko paragrafin 57 në çështjen “*Martirosyan v. Armenia*”, Ap. no. [23341/06](#), Vendim i Seksionit III të Gj.E.D.Nj. dt. 05.02.2013.

⁴⁷ Shiko çështjen “*K.-H. W. v. Germany*”, Vendim i Dhomës së Madhe, Ap. no. 37201/97, paragrafi 45, ECHR 2001-II.

mbajtja pa leje e minave, bombave, lëndëve plasëse – për rrjedhojë edhe në bashkëpunim, e kryer më shumë se një herë dhe me sasi të mëdha apo që ka sjellë pasoja të rënda, janë veprime të dënueshme, pavarësisht se janë shfuqizuar tërësisht paragrafët nga Gjykata Kushtetuese.

Fakti që paragrafët ekzistues ku parashikohen si krime këto veprime kanë si element cilësues banesën, nuk mundet të përjashtojë automatikisht dhe të shërbejë si argument dekriminalizues i të njëjtave veprime të ngjara jashtë banesës. Pyetja që shtrohet në këtë rast, në analogji me retorikën që sjell Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj, është se, a ka kuptim që këto figura veprë penale të jenë të dënueshme vetëm po të ndodhin në banesë dhe nëse ndodhin jashtë saj nuk dënohen, në kushtet kur jashtë banesës veprimet kriminale kanë rrezikshmëri më të fortë? Në fakt nuk ka kuptim, por sipas dispozitës *prima facie* ka.

Në vazhden e arsytimit të jurisprudencës së Gj.E.D.Nj. mbi nenin 7 të K.E.D.Nj., vlerësoj se është e domosdoshme të sjell në vëmendje se, çdo ligj penal material shqiptar që pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot, i marrë në analizë në pjesën e parë të shkrimit, e ka parashikuar si vepër penale armëmbajtjen pa leje dhe mbajtjen pa leje të lëndëve plasëse, sipas çdo forme dhe pavarësisht vendit ku ato mbahen. Kjo do të thotë se, që prej 66 vjetësh asnjë shtetas në Shqipëri nuk ka krijuar pritshmëri të ligjshme dhe në mënyrë të arsyeshme përgjatë dhjetëvjeçarëve, se mbajtja e armëve dhe e lëndëve plasëse jashtë banesës nuk dënohen penalisht.

Në këtë kuptim çdokush ka patur dijeninë e prezumuar kushtetutshmërisht se mbajtja pa leje e armëve dhe e lëndëve plasëse jashtë banesës do të aktivizonte përgjegjësinë penale të tyre në rastin e procedimit nga organet e ndjekjes penale. Ato për më tepër kanë patur dijeni, qoftë edhe pa këshilla të përshtatshme të gjykatës apo avokatëve, se mbajtja e armëve apo e lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente jashtë banesës është një veprim më i rëndë kriminal se sa mbajtja e tyre në banesë, natyrisht për shkak të rëndësisë së hamendësueshme të faktit dhe rrezikshmërisë shoqërore të saj.

Në këtë mënyrë vlerësoj se, askush në Shqipëri nuk mundet të ketë hamendësuar se Gjykata Kushtetuese në të ardhmen do të shfuqizojë si antikushtetues dy paragrafët respektiv të nenit 278 të Kodit Penal dhe se me këtë vendim do të dekriminalizojë mbajtjen e armëve dhe lëndëve plasëse pa leje jashtë banesës, ndërkohë që mbajtja e tyre do të jetë e dënueshme penalisht vetëm në banesë, dhe për këtë arsye subjektet e proceduara më vonë kanë kryer veprimet kriminale, për të cilat sot kërkohet nga organet e ndjekjes penale të dënohen. Ky argument bën të konkludohet se, asnjë ndjekje penale në Republikën tonë, e nisur mbi figurat e veprave penale të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese sipas nenit 278 të Kodit Penal, nuk ka qenë arbitrare dhe nuk mundet të konsiderohet arbitrare.

Në vazhden e këtij arsytimi, vlerësoj se mbajtja e armëve dhe e lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente ka qenë dhe është e dënueshme, pasi shteti asnjëherë nuk e ka dekriminalizuar këtë veprim të kundraligjshëm, qoftë e kurrë në banesë dhe qoftë jashtë saj; qoftë e kryer në sasi të vogla dhe qoftë në sasi të mëdha; qoftë kur ka sjellë pasoja të rënda dhe qoftë nuk ka sjellë pasoja fare; qoftë kur është kryer në bashkëpunim dhe qoftë kur bashkëpunim nuk ka patur. Në këtë mënyrë nuk mundet të justifikohet kushtetutshmërisht asnjë pritshmëri e kujtdo për zbatimin e parimit *nullum crimen sine legge* në rastin konkret, pasi ligj penal ka, ashtu sikurse ka edhe dënim për të.

Pikërisht në këtë situatë të nevojës për të përshtatur paragrafët e mbetur të nenit 278 të Kodit Penal me të gjitha çështjet në hetim dhe në gjykim, protagonist bëhet praktika gjyqësore dhe jurisprudenca. Gjykata Kushtetuese në Vendimin 9/2016 është shprehur ndër të tjera se: “*Duke iu referuar doktrinës së të drejtës penale Gjykata Kushtetuese vlerëson se, prodhimi apo mbajtja pa lejen e organeve kompetente të armëve luftarake është element thelbësor i anës objektive të kësaj*

vepre penale. Kështu, vijon ajo, ligjvënësi e ka konsideruar vepër të dënueshme penalisht mbajtjen e armëve pa leje, pavarësisht nga qëllimi i mbajtjes së tyre (për t'i përdorur ose jo). Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese e vlerëson të pajustificuar përpjekjen e ligjvënësit për të përcaktuar rrezikshmërinë e kësaj vepre penale dhe përcaktimin e masës së dënimit nisur nga kriteret të tilla, si lloji i armës luftarake, dhe në veçanti vendi i mbajtjes së tyre (banesë, automjet, vendi i punës, etj.).”.

Kështu Gjykata Kushtetuese ka nisur fillimin e argumentimit kushtetues të legjitimitetit të dënimit të figurave të veprës penale të shfuqizuara nga vetë ajo. Tashmë i mbetet detyrë gjykatave të pushtetit gjyqësor të bëjnë interpretimin e duhur të ligjit penal material dhe të kualifikojnë juridikisht faktin e servitur për gjykim. Pikërisht praktika gjyqësore, jurisprudenca apo e drejta e gjallë dhe ligji në kuptimin material do të duhet të qartësojnë tashmë zbatimin e nenit 278 të Kodit Penal në këtë zhvillim ligjor të ri të sjellë nga Vendimi 9/2016 i Gjykatës Kushtetuese.

Për rrjedhojë konkludoj se çdo diskutim, aludim apo praktikë hetimore dhe gjyqësore që pushojnë çështjen me arsytimin e nuk ka ligj penal, që të parashikojë mbajtjen pa leje të armëve dhe të lëndëve plasëse jashtë banesës, nuk ka lidhje me ligjin dhe me mbrojtjen e rendit kushtetues. Mbetet të zgjidhet çështja e kualifikimit juridik të figurës së veprës penale dhe individualizimit të marzheve të dënimit respektiv. Dilema e parë kushtetuese ngjan të jetë zgjidhur sakaq.

Zgjidhja Ligjore

Fillimisht vlerësoj se, praktika gjyqësore, që konkludon se, në kushtet kur janë shfuqizuar ndryshimet e ligjit penal, *ipso legge* hyn në fuqi norma e shfuqizuar më parë, më konkretisht neni 278 i Kodit Penal para vitit 2013, është jokushtetuese dhe në vetvete përbën dënim pa ligj. Duhet të kuptohet se ligji, që është shfuqizuar nga ligji që shpallet më vonë antikushtetues, nuk kthehet dot në fuqi veçse me miratimin nga Kuvendi si ligj edhe një herë. Shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese e një ligji nuk sjell përtëritjen e ligjit të shfuqizuar më parë. Kjo as nuk mundet të nënkuptohet dhe as mundet të argumentohet, pasi ligjbërja është kompetencë kushtetuese e pushtetit ligjvënës dhe se vetëm Kuvendi mundet të mbushë boshësinë ligjore të krijuar nga vendimi shfuqizues. Ligji nuk mundet të ngjallet me një interpretim të tillë.

E gjithë kjo tezë është mbështetur mbi një prezumim dhe konkluzion që nuk bazohet në Kushtetutë dhe as në ligj. Ka vetëm një normë të tillë në rendin juridik tonë, por që ajo nuk i kushtohet ligjit, por ekskluzivisht aktit administrative dhe në një kontekst krejt tjetër. Kjo dispozitë është neni 127 i Kodit të Procedurave Administrative dhe kurrësesi nuk mundet të zbatohet me analogji për regjimin juridik të ligjit të shfuqizuar, pasi nuk ka legjitimitet kushtetues.

Megjithatë edhe sikur të merret e mirëqenë kjo analogji e pavend, sërish edhe përtëritja e fuqisë së aktit administrative të shfuqizuar më parë varet nëse akti shfuqizues shpreh vullnetin e organit vendimmarrës për përtëritjen e fuqisë apo jo. Kjo është arsyeja që ligji organik për Gjykatën Kushtetuese sa herë që gjykata shfuqizon ligjin ia njofton vendimin Kuvendit apo Këshillit të Ministrave, me qëllim që të merren nismat ligjore respektive për të plotësuar boshësinë ligjore e mbetur.

Në këtë kuptim vlerësoj se dënimi me një dispozitë të shfuqizuar përbën dënim pa ligj dhe shkelje e parimit kushtetues *nullum crimen sine legge*. Në kushtet kur nuk ka asnjë bazë kushtetuese dhe ligjore për këtë lloj përtëritje të ligjit penal në kohë, është e pamundur që në

mënyrë të arsyeshme t'i kundrejtohet dijenia e këtij interpretimi qoftë me ndihmën e iluminimit të vendimit gjyqësor, apo qoftë me asistencën dhe ndihmën ligjore të një këshilltari apo avokati. Për rrjedhojë kjo mënyrë interpretimi dhe zbatimi e ligjit do të jetë arbitrare dhe e paparashikueshme dhe njëlloj edhe e paaksesueshme për subjektet destinatar. Për më tepër kjo mënyrë interpretimi është e njëllojtë sikur gjykata të bënte ligjin penal *ex novo*. Për rrjedhojë vlerësoj se kjo mënyrë e zbatimit të ligjit penal përbën shkelje të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të K.E.D.Nj..

Nga ana tjetër, vlerësoj se edhe interpretimi i Vendimit 9/2016 i Gjykatës Kushtetuese mbi fjalën "banesë" në paragrafët e mbetur në nenit 278 të Kodit Penal është eksisiv dhe joligjor. Gjykata Kushtetuese nuk ka konkluduar se, elementi i vendit kur ndodhin veprat penale është jokushtetues, e për pasojë nuk mundet të konkludohet se në mënyrë të heshtur Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar këtë element të veprës penale. Në këtë kuptim, edhe nëse ligjvënësi do të ndryshonte sërish nenin 278 të Kodit Penal dhe do të parashikonte në paragraf të veçantë figura të veprës penale që kanë si element cilësues vendin, ndryshimi ligjor nuk do të jetë potencialisht jokushtetues për këtë argument, por vëmendja do të duhet të përqëndrohet në proporcionalitetin e sanksionit të parashikuar.

Ndërkohë përse i përket dilemave të ngritura nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerësoj se Vendimi 9/2016 i Gjykatës Kushtetuese, megjithë mangësitë që ka dhe mospërputhjen e pjesës dispozitive me pjesën arsyetuese, nuk është i paqartë dhe si i tillë nuk ka nevojë për interpretim të mëtejshëm nga Gjykata Kushtetuese. Nevoja për interpretimin e tij tashmë lind dhe i kundrejtohet si detyrim gjykatave të pushtetit gjyqësor dhe jo jashtë tij. I mbetet gjykatave detyra që nëpërmjet jurisprudencës dhe praktikës gjyqësore të qartësojnë zbatimin e nenit 278 të Kodit Penal për rastet e figurave të veprës penale të shfuqizuara nga Vendimi 9/2016 i Gjykatës Kushtetuese. Gjykatat kanë për detyrë të qartësojnë zbatimin e nenit 278 të Kodit Penal në këtë kontekst të ri të zhvillimit të legjislacionit penal dhe ta përshtasë atë në boshësinë ligjore të krijuar nga shfuqizimi eksisiv i Gjykatës Kushtetuese.

Në rastin konkret, duke qenë gjykatat po ndjekin praktika gjyqësore të ndryshme, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk do të duhej t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për interpretim apo të vendimit shfuqizues. Përkundrazi këtë kohë të humbur, nga moment i pezullimit të gjykimit dhe deri në momentin e revokimit të vendimit të pezullimit, pasi Gjykata Kushtetuese të jetë shprehur lidhur me kërkesën, Kolegji Penal do të duhet të kishte marrë iniciativën e zhvillimit të gjykimit unifikues mbi zbatimin e nenit 278 të Kodit Penal për figurat e veprave penale të shfuqizuara tashmë nga Gjykata Kushtetuese. Pikërisht vendimi unifikues penal, në bazë dhe për zbatim të nenit 141 të Kushtetutës, do të kishte zgjidhur në mënyrë ezauruese çdo problematikë të mundshme eventuale në praktikën gjyqësore të gjykatave më të ulëta. Natyrisht një vendimmarrje e tillë pritej nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe autoriteti ekskluziv i nomofilatisë në vendin tonë.

Njëlloj antikushtetuese është edhe praktika gjyqësore e ndjekur nga gjykatat, në periudhën gjatë gjykimit dhe pritjes së botimit në Fletore Zyrtare të Vendimit 9/2016 të Gjykatës Kushtetuese. Të gjitha vendimet gjyqësore të dënimit, sipas paragrafëve të shfuqizuar në nenit 278 të Kodit Penal, gjatë kësaj kohe kanë zbatuar një ligj antikushtetues, kur kanë artikuluar sanksionin e dhënë. Për të gjitha këto vendime do të zbatohet me fuqi prapavepruese vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Këto vendime gjyqësore, duket se, më shumë se sa për të zbatuar ligjin, janë nxituar të heqin nga gjykimi çështjet që së shpejti do të shëndrroheshin në një dilemë të vështirë për t'u zgjidhur. Në vlerësimin tim edhe këto vendime përbëjnë dënim pa ligj në kuptimin material, pavarësisht se në kuptimin formal kanë zbatuar një ligj akoma të pa shfuqizuar, por të

njoftuar paraprakisht se për çështje ditësh apo javësh ligji që u zbatua prej tyre do të shfuqizohej në momentin kur Vendimi 9/2016 do të botohej në Fletoren Zyrtare. Të gjitha këto vendime, gjatë pritjes së shqyrtimit të ankimit, do të jenë objekt ndryshimi nga gjykata më e lartë, për të rivendikuar sakaq kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e dënimit.

Mbetet tashmë të fokusohem në zgjidhjen ligjore të premtuar nga ky shkrim për të gjitha çështjet penale në hetim dhe në gjykim, ku akuza është artikuluar sipas njëres prej figurave të veprave penale të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese. Sikurse afërmendsh mundet të kuptohet, zgjidhja ligjore në vlerësimin tim është kualifikimi ligjor i figurave të veprës penale të mbajtjes së armëve dhe lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente jashtë banesës sipas paragrafëve ekzistues respektiv të nenit 278 të Kodit Penal që penalizon këto veprime kriminale në banesë.

Për të gjitha arsyet e dhëna më lart, përshtatja që praktika gjyqësore dhe jurisprudenca e së drejtës së gjallë ka mision për të bërë në rastin konkret, është zgjidhja ligjore që ka shkaktuar boshësia e lënë pa kuptim dhe me kuptim nga Gjykata Kushtetuese. Kështu veprimet kriminale të figurave të veprës penale të shfuqizuara tashmë do të duhet të kualifikohen dhe dënohen sipas veprës penale dhe dënimit të mbetur në nenin 278 të Kodit Penal, për të cilën Gjykata Kushtetuese është shprehur në fundin e vendimit se nuk u konstatuan element antikushtetutshmërie.

Në këtë kuptim elementi vend, i individualizuar si “*banesë*” në paragrafët e mbetur të nenit 278 të Kodit Penal, nuk duhet të interpretohen më gjyqësisht, në këtë kontekst të ri të zhvillimit të legjislacionit penal material, si element konstitutiv dhe *sine qua non* i veprës penale të dënueshme, por duhet të interpretohet si element indikativ, që ndikon në rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe për rrjedhojë edhe të autorit. Ky element, në këtë kontekst të ri të zhvillimit të ligjit penal material, duhet të mbahet parasysh nga gjykata për caktimin e dënimit rast pas rasti, në kuptim të nenit 47 të Kodit Penal, por jo më si element që dikton kualifikimin juridik të veprës apo të figurës së veprës penale.

Kjo mënyrë interpretimi detyron prokurorinë, që për çështjet e ndodhura gjatë fazës së hetimit paraprak, të ndryshojë kualifikimin juridik të veprës, jo më sipas paragrafëve të shfuqizuar por sipas paragrafëve ekzistues të nenit 278 të Kodit Penal. Formalisht dhe proceduralisht organi i akuzës duhet t’ia komunikojë vendimin për ndryshimin e akuzës dhe kualifikimin juridik të veprës penale, për t’i dhënë mundësi sakaq të pandehurit të mbrohet. Kjo zgjidhje, në bazë dhe për zbatim të nenit 372 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të diktojë sjelljen procedurale të prokurorit edhe gjatë gjykimit, nëse kërkesa për gjykim është paraqitur tashmë. Ndërkohë që gjitha gjykatat që kanë në gjykim vepra të tilla penale, nëse nuk vepron proceduralisht organi i akuzës sipas nenit të sjellë në vëmendje më lart, do të duhet që në vendimin përfundimtar të realizojë ndryshimin e kualifikimit juridik të veprës penale, në bazë dhe për zbatim të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale. Problem nuk do të shfaqet as në gjykimet e zhvilluara sipas rritit të posaçëm të gjykimit të shkurtuar, duke qenë se akuza e re e çdo të pandehuri do të jetë në çdo eventualitet më e favorshme se sa ajo që ka lënë pas, për shkak të shfuqizimit që ka bërë Gjykata Kushtetuese.

Ndërkohë zgjidhja më e paqtë dhe më adekuate për sqarimin dhe eliminimin e çdo paqartësie në mënyrën se si zbatohet neni 278 i shfuqizuar i Kodit Penal, do të jetë vendimmarrja unifikuese nga organi më i lartë gjyqësor dhe institucioni ekskluziv që realizon procesin kushtetues të nomofilatisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Më tej kjo çështje kaq nxehtë e debatuar do të tejkalohet. Zbatimi i nenit 278 i Kodit Penal në këtë mënyrë do të futet në hullitë e zakonshëm të zbatimit të ligjit.

REFERENCA

Ligji nr. 5591, datë 15.6.1997 Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë

Kodi Penal i Bashkimit Sovjetik i vitit 1966;

Kodi Penal i Republikës së Armenisë i vitit 1966;

Dekretin Nr. 2868, datë 16.3.1959 “*Mbi shpalljen e Kodit Penal të Reprublikës Popullore të Shqipërisë*” i aprovuar nga Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë me Ligjin Nr. 1470, dt. 23.05.1952 dhe i ndryshuar me Dekretin Nr. 2477, dt. 03.06.1957 dhe me Ligjin nr. 2804, dt. 04.12.1958;

Kodi i Procedurave Administrative;

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji Nr. 8577, 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;

Kodi i Procedurës Penale;

Ligji Nr. 98/2014, datë 31.07.2014;

Ligji 135/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 8279, datë 15.1.1998 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 8733, datë 24.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;

Ligji Nr. 144/2013, datë 2.5.2013;

Kodi i Procedurave Administrative;

Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;

Karta për të Drejtat e Njeriut të Bashkimit Evropian;

Ligjin Nr. 8984, dt. 23.12.2002 “*Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatë Ndërkombëtare Penale*”;

Ligjit nr. 8175, datë 23.12.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;

Florjan Kalaja, “Dilema Kushtetuese I”, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Tiranë 2016;
Vendim nr. 9 datë 26.02.2016 i Gjykatës Kushtetuese;

Çështja “*Martirosyan v. Armenia*”, Vendim i Seksionit III të Gj.E.D.Nj. dt. 05.02.2013, Ap. No. 23341/06;

Vendimi Nr. 52909-00674-00-2015, Akti, Nr. 00-2016- i Vendimit (), dt. 10.03.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

Vendimi nr. 9, dt. 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr.12, datë 14.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr. 13, datë 29.05.1997 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr. 65, datë 10.12.1999 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr.8, datë 16.03.2011 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr. 23, datë 04.11.2008 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr. 11, datë 02.04.2008 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr.7, datë 09.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi nr. 52, dt. 02.12.2013 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi Nr. 51, dt. 12.11.2014 i Gjykatës Kushtetuese;

Vendimi Nr.13, datë 29.5.1997 të Gjykatës Kushtetuese;

Çështja “*Contrada v. Italy (3)*”, Vendim i Seksionit IV i Gj.E.D.Nj. dt. 14.04.2015, Ap. No. 66655/2013;

Çështja“*Cantoni v. France*”, Vendim i Gj.E.D.Nj. 15.11.1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-V;

Çështja “*Cowme and Others v. Belgium*”, Ap. nos. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, Vendim i Gj.E.D.Nj., ECHR 2000-VII;

Çështja “*Sud Fondi S.r.l. and Others v. Italy*”, Ap. no. 75909/01, Vendim i Gj.E.D.Nj. dt. 20.01.2009;

Çështja “*Ashlarba v. Georgia*” A. No. 45554/08, Vendim i Seksionit IV të Gj.E.D.Nj. dt. 15.07.2014;

Çështja “*Del Río Prada v. Spain*”, Vendim i Dhomës së Madhe të Gj.E.D.Nj., Ap. no. [42750/09](#), viti 2013;

Çështja “*S.W. v. the United Kingdom*”, Vendim i Gj.E.D.Nj. dt. 22.11.1995, Series A no. 335-B;

Çështja “*C.R. v. the United Kingdom*”, Vendim i dt. 22.11.1995, Series A no. 335-C);

Çështje “*Dallas v. The United Kingdom*”, Ap. No. [38395/12](#), Vendim dt. 11.02.2016 i Seksionit I të Gj.E.D.Nj.;

Çështja “*Rohlena v. the Czech Republic*”, Vendim i Dhomës së Madhe, Ap. no. [59552/08](#), ECHR 2015;

Çështja “*Ashlarba v. Georgia*” A. No. 45554/08, Vendim i Seksionit IV të Gj.E.D.Nj. dt. 15.07.2014;

Çështja “*Achour v. France*”, Vendim i Dhomës së Madhe dt. 29.03.2006, Ap. no. 67335/01, paragrafi 54, ECHR 2006-IV;

Çështja “*Scoppola v. Italy (no. 2)*”, Vendim i Dhomës së Madhe dt. 17.09.2009, Ap. no. [10249/03](#);

Çështja “*Huhtamäki v. Finland*”, Ap. no. 54468/09, Vendim i Gj.E.D.Nj. dt. 06.03.2012;

Çështja “*Dallas v. The United Kingdom*”, Ap. No. [38395/12](#), Vendim dt. 11.02.2016 i Seksionit I të Gj.E.D.Nj.;

Çështja “*Martirosyan v. Armenia*”, Ap. no. [23341/06](#), Vendim i Seksionit III të Gj.E.D.Nj. dt. 05.02.2013;

Çështja “*K.-H. W. v. Germany*”, Vendim i Dhomës së Madhe, Ap. no. 37201/97, ECHR 2001-II;

Fletore Zyrtare Nr. 31. Dt. 29.02.2016;

Fletore Zyrtare Nr. 132, dt. 19.08.2014;

Fletoren Zyrtare Nr. 249, dt. 14.01.2016;

Fletore Zyrtare Nr. 83, dt. 20.05.2013;

Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966;

<http://www.balkanweb.com/site/armembajtja-pa-leje-manjani-vendos-hartimin-e-nje-pr-ligji-te-ri/>;

http://www.pp.gov.al/web/statuti_i_romes_per_gjykatën_nderkombetare_penale_813.pdf;

THE RELATIONSHIP BETWEEN POLITICAL ELITES AND THE DEMOCRATIZATION PROCESSES, AN ANALYTICAL OVERVIEW CASE OF ALBANIA

MSc.Fabiola Deliaj
SHPAL" Pavarësia", Vlorë
ALBANIA
E-mail: fabiola.deliaj@unipavaresia.edu.al

ABSTRACT

Exactly, it will be the movement of the elite, which is going to make possible the recycling of the elite and a new spirit of governance, in reforms of democratization and integration of the country. Without this kind of cycle, we cannot have democratization, because holding jurisdiction for a long time, is dangerous and not cycling the leaders makes harder the democratization. Provisions haven't and never will have a creative role. History is the act of great personalities or active minorities who still act. Shortage is exactly the healthy democratization of the country. Democracy does not come from "The Holy Spirit", but inherits a variety of the past traits, which complicate the process of the regime change.

Keywords: Demokratizimi, Elitë Politike, Klasë Politike, Klientokraci

HYRJE

"The death of a dictator does not guarantee the birth of democracy" Samuel Huntington
"Members of the old regime...may pretend that they have defeated dictatorship, but in fact they're just asking to bring a new painted model of the old one" Gene Sharp

Në këtë punim do të përpiqem të sjell rolin e elitave në demokratizimin e vendit. Një marrëdhënie utopike mes koncepteve të mirë përcaktuara dhe shtrirjes së tyre në realitetin politik shqipëtar të vrazhdë. E teksa përpiqesh t'i unifikosh të dyja arrin në përfundimin e një kompleksiteti të madh, pa fund e krye. Demokratizimi është faktor kryesor zhvillimi , emancipimi. Liderat politikë të vendit janë persona tek të cilët rëndon kjo peshë në bazë të kriterit të demokracisë përfaqësuese dhe standartit të demokracisë funksionale. Roli i tyre është i drejtpërdrejt në integrimin dhe në demokratizimin e vendit. Elitat janë parë si grupe të vogla, të cilat luajnë rol të madh e ndikues në çështjet politike e sociale. Duke u nisur nga ky fakt, edhe në vendin tonë ekzistojnë elitat si dhe luajnë një rol thelbësor dhe kyç në aspiratat dhe sfidat me të cilat shtetet dhe qeveritë përballen. Elitat janë "vendimmarrëset" e shoqërisë, pushteti i të cilave nuk i nënshtrohet asnjë organi tjetër në shoqëri (Parry,2010:25). Pushteti i elitave është shumë i madh dhe i panënshtuar ndaj asnjë organi tjetër , i cili çfarëdo qoftë rrjedh prej tyre dhe nuk mund t'i kundërshtojë apo dalë kundër tyre. Por, nisur nga kjo, lind edhe një problem tjetër në disa raste, si pasojë e pushtetit të pakufizuar të elitave. Ashtu si argumenton edhe Parry (2010): Elitat janë parë si kërcënimi kryesor për mbijetesën e demokracisë. Ekzistenca e tyre është marrë si një mohim i vërtetë i demokracisë. Elitat ,që kanë mundësi të jashtëzakonshme të zënë "pozicione kyçe" në shoqëri, ose që ushtrojnë kontroll mbi politika të rëndësishme në shpërpjestim me numrin e tyre , me të drejt mund të duket se janë kontradikta të gjalla të

nacionit “qeverisje e popullit”. Duke u nisur nga ky këndvështrim, pikë së pari duhet bërë një përcaktim mjaft domethënës për konceptimin e realitetit politik shqiptar. Sot, shumë politologë dhe analistë të politikës flasin për rinovimin e politikës dhe qarkullimin e elitave politike. E kuptojnë të gjithë që qarkullimi i elitave politike është një domosdoshmëri imediate, në mënyrë që shoqëria të ecë përpara, por askush nuk arrin të shpjegojë se si mund të realizohet në praktikë ky qarkullim. E pra, kyçi i suksesit të qarkullimit të elitave është tek ndarja e elitave partiake nga elitat politike (Liçi, 2007). Ashtu si Moska, edhe Pareto e ndante elitën në dy kategori. Për të, elita ndahet në “elitë qeverisëse” dhe “elitë jo qeverisëse”. Së pari, është mirëpranuar se rregjimi komunist la një model të keq-qeverisjes. Rregjimi komunist krijoi “një elitë pa ndjenjën e përgjegjësisë ndaj komunitetit, me frikën ndaj pushtetit të më të fuqishmit, të paaftë për t’i rezistuar të keqes¹. Duke mbajtur parasysh faktin se, drejtuesit e rinj politikë të pas viteve ‘90 “kishin dalë tërësisht nga elita e kohës së komunizmit²”, përvojat dhe njohuritë e tyre në pluralizëm reflektonin ndikimet nga modeli i kaluar politik.

MARRËDHËNIA MES ELITAVE POLITIKE E PROCESIT TË DEMOKRATIZIMIT

Duke iu referuar rastit të Shqipërisë, nëse marrim në konsideratë parakushtet për demokracinë, në kohën kur vendi u hap drejt Perëndimit, ai plotësonte vetëm një të tillë: atë të homogjenitetit etnik. Parakushtet e tjera të një vendi normal pothuajse nuk ekzistonin aspak. Funksionimi dhe konsolidimi i rendit demokratik përbën një prej shumë zhvillimeve të mundshme të procesit të tranzicionit. Më konkretisht, nuk kishte përvojë të pluralizmit politik (ose shumë shkurt, midis viteve 1920 – 1930), Shqipëria ishte një vend feudal, pa shtresë të mesme dhe e pazhvilluar ekonomikisht, e vetëizoluar, që do të thotë, pa asnjë lloj ndikimi politik, shoqëror e ekonomik nga Perëndimi i zhvilluar dhe demokratik, një shoqëri e pamodernizuar, pothuajse pa traditë të shoqërisë civile dhe “kampion” i dhunimit si edhe i mosrespektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Por, a kishte Shqipëria premisa për fillimin e ndryshimeve demokratike? Vështirë të thuhet, sepse vendi u karakterizua nga një izolim i tejskajshëm pothuajse për pesë dekada, që për pasojë mbeti në periferi të vëmendjes së Perëndimit, pa rëndësi strategjike, as rajonale, as globale. Shqipëria jo vetëm që ishte një vend me sistem njëpartiak, por dhe me një mungesë të madhe të mediave të lira, pa sistem gjyqësor të pavarur dhe pa organizime të pavarura të shoqërisë civile.

Kështu që viti 1990, përtej një tradite të shkurtër të një demokracie (të pjesshme), u duk sikur do të shënonte fillimin e demokracisë së vërtetë në Shqipëri, gjë që do t’a vështirësonte dhe do t’a zgjaste natyrshëm edhe tranzicionin demokratik drejt konsolidimit demokratik. Pra, kalimi në demokraci filloi në rrethana dhe në pozita shumë më të vështira, por edhe me barriera më të mëdha, krahasuar me vendet e tjera të ish –Lindjes komuniste. Po ashtu, konteksti rajonal ishte i pafavorshëm për një tranzicion demokratik normal, duke shtuar dhe rrezikun e rrymave të rrezikshme të paqëndrueshmërisë, që i vinin nga jashtë, si nga ish-Jugosllavia, nga Serbia, nga Kosova, etj. Pra, për shkak të historikut të këtyre vendeve, braktisja e komunizmit filloi me

¹ Lubonja, F. “Tranzicion apo Kalbëzim” në “Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë” Ciencias y humanismo, fq. 231.

² Misha, P. “Roli i trashëgimisë historike në tranzicionin pas-komunist Shqiptar” në “Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë” Ciencias y humanismo, fq. 143.

“marrëveshjen e elitave)³”. Po në këtë linjë mendimi, Hyppolite Taine pranon se “Masat nuk kanë patur dhe kurrë nuk do të kenë një rol krijues: historia është vepër e personaliteteve të mëdha, ose të paktën e pakicave aktive dhe që veprojnë (Bravo&Malandrino,1994)”.

Bogdani , në të njëjtën linjë, shtron edhe një argument tjetër kur arsyeton se, përveç gjithë këtyre faktorëve afat-gjatë e afat-mesëm, një faktor kryesor, që ka penguar Shqipërinë të arrijë rezultate pozitive në demokratizim dhe zhvillim gjatë tranzicionit ka qenë udhëheqja e dobët, e paaftë dhe e papërgjegjshme politike (Bogdani&Loughlin,2004). Bogdani dhe Loughlin këtu duan të thonë se klasa politike shqiptare është treguar edhe egoiste, edhe e paaftë për të bashkëpunuar dhe dialoguar në çështje, të cilat në parim mund të ishin shumë më të lehta për t’u zgjidhur dhe për të pasur sukses, sesa sjellja e aktorëve politikë, të cilët nuk kanë ndihmuar në këtë drejtim, por kanë luftuar më shumë për të fituar dhe mbajtur pushtetin. Duhet theksuar edhe fakti që, rol kyç në politikëbërjen dhe marrjen e vendimeve në emër të të gjithëve e kanë elitat partiake. Debatimi se çfarë quhet elite politike dhe kush realisht është elita politike në Shqipëri është një debat pa fund e krye.

Pavarësisht prej kësaj, studiues të tjerë i kanë parë elitat si mburojë të demokracisë, që e mbrojnë atë nga rreziqet e totalitarizmit . Ky model i elitave është një model që premtton stabilitet dhe një qeverisje të qëndrueshme dhe ajo që është më e rëndësishme, të aspirojnë dhe të arrijë përmbushjen e detyrimeve të ndërmarra prej tyre Por, kur kthehemi të flasim për vendin tonë, pas rënies së diktaturës, nga viti 1991 deri më sot, nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë e që në rastin tonë përkon me arritjen e asaj ambicie për të cilën shqiptarët kanë dëgjuar e endërruar çdo ditë, që pas ndërrimit të pushtetit në vitin ‘92.

“Sa më shumë rritet dëshpërimi me situatën politike dhe ekonomike në vend, aq më shumë integrimi shikohet si e vetmja rrugë shpëtimi, duke e dogmatizuar kështu procesin deri në atë pikë saqë ai bëhet krejtësisht i pakontestueshëm, mbi dhe jashtë debatit publik. Vizioni i politikës dhe politikanëve shqiptarë, qoftë atyre në qeveri apo atyre në opozitë, është një vizion ende i pamotivuar dhe ka krijuar mjaft debate mes studiuesve dhe analistëve shqiptarë (Kajsiu,2006)”.

Që sistemi politik aktual shqiptar nuk mund të quhet ‘demokraci’, është një fakt i pranuar gjerësisht. Mjafton këtu të mundohemi të barazojmë konceptin me atë sesi përkufizohet realisht në Shqipëri. Ama, nëse ekziston një konsensus i gjerë se sistemi politik shqiptar nuk është ende demokraci, nuk është e qartë se çfarë është ky sistem. Një pjesë e mirë mendojnë se sistemi politik shqiptar është autoritarist. Ndërsa pjesa më e madhe mendon se sistemi ynë politik mund të klasifikohet si ‘oligarki’. Me pak fjalë “ligji i hekurt i oligarkisë” shpjegon tendencën që të gjitha organizimet politike priren të jenë oligarkike. E siç ka thënë Platoni “oligarkitë udhëhiqen nga injorantë”, këtu tek ne, një grusht politikanësh, së bashku me një grusht biznesesh dhe mediash, e përdorin pushtetin në funksion të interesave të tyre. Edhe në këtë pikë mjafton të vendosim përballë njëri-tjetrit konceptin elitë politike me elitë politike shqiptare. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me klasifikime që i afrohen, por nuk e përshkruajnë plotësisht realitetin tonë politik. Në të njëjtën mënyrë, ideja se Shqipëria qeveriset nga një grusht oligarkësh shqiptarë, fsheh kompleksitetin e sitemit tonë politiko-ekonomik. Së pari, koncepti i oligarkisë injoron rrënjët sociale të pushtetit . Prandaj, besoj se koncepti që do t’a përshkruante më mirë sistemin

³ Marrëveshja e elitave (një term i përdorur nga studiuesit Field, Higley dhe Burton) ka të bëjë me bisedimet që bënë komunistët më opozitarët e regjimit. Në Shqipëri elita opozitare përfaqësohej nga intelektualët dhe studentët, të cilët bënë marrëveshje për hapjen e vendit drejt pluralizmit.)

tonë politik, do ishte, si studiuesi Blendi Kajsia e ka përcaktuar “klientokracia”⁴. Njësia bazë e sistemit tonë politik është klientela. Klientela është një rrjet i ndërvarur interesash, që në mënyrë direkte shpërndan përfitime të veçanta për anëtarët e saj. Për këtë qëllim, klientela synon marrjen ose influencimin e pushtetit politik, por jo vetëm. Edhe lufta politike që zhvillohet sot në Shqipëri, është një luftë mes (dhe herë - herë brenda) klientelave të ndryshme.

Deri diku, klientokracia shqiptare i ngjan demokracisë pluraliste të analizuar nga Robert Dahl, ku interesa të ndryshme përplasen për të përcaktuar vendimmarrjen. Ndryshimi nga ideali i demokracisë pluraliste të Dahlit qëndron në dy aspekte. Së pari, klientokracia shqiptare nuk konsiston në përplasjen e interesave të përgjithshme, (punëdhënësit përballë punëmarrësve), por në përplasjen e interesave të veçanta (media pranë pushtetit me median pranë opozitës). Së dyti, sistemi klientokratik shqiptar e nxjerrë jashtë lojë vetë idenë e qeverisjes nga shumica, sepse ai nuk është në funksion të interesit të përgjithshëm të shumicës, por të interesave të veçanta të klientelës, nga qendra në bazë.

Të kuptosh klientokracinë shqiptare dhe mënyrën e saj të funksionimit, do të thotë të kuptosh disa nga sfidat dhe dështimet e vazhdueshme të sistemit tonë politik. Struktura klienteliste shpjegon jo vetëm përhapjen e korrupsionit, por dhe limitet e luftës kundër tij. Për pasojë, sistemi politik shqiptar ka prodhuar vetëm një model, një stil drejtimi, që bashkon modelin e sotëm rus të oligarkisë dhe modelin komunist të liderit suprem dhe të përjetshëm. Fakti që partitë shqiptare mbeten ndër të vetmet në rajon dhe më tej, që nuk pranojnë rotacionin demokratik, ku partia vihet në funksion 100% të interesave, qëndrimeve, familjeve dhe axhendës politike, ku periodikisht dhe publikisht shkelet në mënyrë konsensuale detyrimi për zgjedhje dhe konkurrencë të lirë, është tregues simbolik i kapjes së sistemit partiak, pafuqisë së tij për të gjeneruar ide dhe projekte të reja, pamundësisë për reformim dhe pushtetit të tyre ekstra-kushtetues mbi institucionet dhe jetën publike (krasniqi,2013).

Por, përse ka vlerë që partitë të jetë demokratike nga brenda dhe që jeta politike të kryejë rotacion të vazhdueshëm elitash? Së pari, sepse është detyrim kushtetues bazuar në nenin 9. Së dyti, sepse sistemi piramidial i partive nominale e klanore rrezikon shkëputjen nga shoqëria dhe krijimin e një oligarkie arrogante dhe imponuese, shpesh në formë konsensuale, mbi qytetarët. Së treti, sepse partitë ,që nuk janë demokratike nga brenda, liderët politikë, që nuk janë demokratikë në familjet e tyre politike, nuk janë dhe nuk mund të jenë demokratë në mentalitet e funksion në krye të shtetit, jashtë familjes politike. Së katërti, sepse në një shoqëri ende të mbyllur si shoqëria shqiptare, me një të kaluar të mbushur me sundimtarë dhe me një demokraci pa demokratë, ekzistenca e modeleve demokratike është jetike, është rrugëzgjdhje dhe garanci. Së fundi, sepse sistemi piramidial në partitë politike, imponohet si model sukcesi në publik, përmes krijimit të sistemeve piramidale në qeverisjen qendrore e lokale, në media e biznes, në kontrollin personal të burimeve ekonomike dhe jetës publike, - dhe kështu, ai deformat në thelb vlerat dhe parimet e demokracisë përfaqësuese, minon besimin tek demokracia dhe sjell zhgënjime tek qytetarët dhe partnerët tanë ndërkombëtarë.

PËRFUNDIME

Në përkufizimin e studiuesve T. Karl dhe C. Schmitter, tranzicioni nuk është veçse “...një periudhë e madhe pasigurie politike. Ai u nënshtrohet pasigurive të paparashikuara, proceseve të

⁴ http://mobile.ikub.al/LAJME_CATEGORY/LAJME_CATEGORY/Lajme/Klientokracia-shqiptare-Nga-Blendi-KAJSIU--

pafundme dhe rezultateve të paimagjinueshme.” Frenimi i Shqipërisë në arritjen e rezultateve pozitive në reforma, zhvillim, demokratizim dhe integrim në familjen Evropiane, është ndikuar dukshëm nga klasa politike e këtyre 25 viteve tranzicioni të tejzgatur. Klasa politike është aktori më i rëndësishëm në politikëbërje dhe në Shqipëri, ndryshe nga të gjitha vendet ish-komuniste, liderët politikë historikë janë aktivë dhe në konkurrencë për poste të larta drejtuese. Në dy dekadat e fundit, skena politike shqiptare është pothuajse dominuar nga të njëjtët aktorë politikë. Politikëbërja konsiderohet një proces paktesh, negociatash dhe kompromisesh ndërmjet aktorëve dhe riciklimi i tyre bëhet i domosdoshëm për zhvillimin e demokracisë dhe të vendit në tërësi. Studiuesit theksojnë se: “Pavarësisht plejadave relativisht të favorshme, kalimi në demokraci mund të dështojë kur mungon vullneti dhe kur veprohet politikisht me ngathtësi dhe që të dyja këto janë elemente shumë të pranishme në politikën shqiptare. Kjo vihet në dukje edhe nga deklarata e eurokomisionerit për Zgjerimin, z. Stefan Fyle, i cili thekson se “mungesa e kulturës së kompromisit.”⁵ është çështje kritike. Thelbi teorik i doktrinës elitiste është se, në shoqëri mund të ekzistojë një pakicë popullsie, që merr vendime të mëdha... duke ndikuar aspektet më të përgjithshme të shoqërisë, ato zakonisht njihen si vendime politike. Tezat elitiste nuk pohojnë thjesht se, në një shoqëri, pakica merr vendime dhe shumica bindet; argumenti elitist është një argument më i fortë: Pakica mbizotëruese nuk mund të kontrollohet nga shumica, çfarëdolloj mekanizmash demokratike të përdoren.

BIBLIOGRAFIA

- Angjeli,A.(2013). “Ditari i Tranzicionit Ekonomik”, Toena &UMSH Press, Tiranë
- Blendi Kajsiu”*Klientokracia Shqiptare*”, Gazata Panorama, 15.01.2011Bogdani, M. Loughlin, J.(2004). *Shqipëria dhe Bashkimi European*. Tiranë, Dajti.
- Kajsiu, B.(2006). *Integrimi si pengesë për demokracinë*. Tiranë, Polis 2Kajsiu, B.(2007). *Demokratizimi pa politikë: Baza konceptuale e qasjes ndërkombëtare në Shqipëri*. Tiranë, Polis 4
- Krasniqi, A.(2008). *(Mbi)Pushteti i partive*. Tiranë, Gjergj Fishta
- Krasniqi,A.“*Sistemi Politik dhe Partite Politike ne Shqiperi* ”*Shkrimi u publikua sot (11.12.2013) në gazetën Shqiptarja.com*
- Liçi, I.(2007). *Rruga e vetme drejt demokracisë*. Tiranë, Marin Barleti
- Lubonja,F. “*Tranzicion apo Kalbëzim*” në “*Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë*” Ciencias y humanismo
- Manfred G. Schmidt,(2012). “Teoritë e Demokracisë”, Botart, Tiranë
- Manfred G. Schmidt.(2012).“Teoritë e Demokracisë”, Botart, Tiranë
- Michels,R.(1958) “Political parties”, Free Press Glencoe

⁵ <http://www.ama-news.al/2013/02/fyle-ne-shqiperi-mungon-kultura-e-kompromisit/>

Parry,G.(2010) “Elitat Politike”, Botimet Dudaj, Tiranë.

Piro Misha, *“Roli i trashëgimisë historike në tranzicionin pas-komunist Shqiptar” në “Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë”* Ciencias y humanismo

Terry Lynn Karl and Philippe C. Schmitter, “Models of the transition in Latin America, Southern and Eastern Europe” në Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim”, Botimet Dudaj, Tiranë

http://mobile.ikub.al/LAJME_CATEGORY/LAJME_CATEGORY/Lajme/Klientokracia-shqiptare-Nga-Blendi-KAJSIU--

<http://www.ama-news.al/2013/02/fyle-ne-shqiperi-mungon-kultura-e-kompromisit/>

<http://www.mapo.al/2015/04/tonin-gjuraj-demokratizimi-shqiperia-nje-rast-sui-generis>

FUTURE CHALLENGES OF PUBLIC FINANCES IN ALBANIA

Dr. Veronika Durmishi

Faculty of Economy and Social Sciences

SHPAL “Pavarësia“, Vlorë

ALBANIA

e- mail: veronika_durmishi@unipavaresia.edu.al

ABSTRACT

Public finances and the problems associated with them are issues all governments, regardless of political system or the level of economic development of countries. For any government it is important to balance public spending with income, in order to provide public services, redistribution of income and bearing the cost for the proper functioning of the state.

In this paper we examine and handle in a scientific way, public finance problems in Albania and do a comparison with countries in the region. Through a comparative methodology, this paper will be treated in a specific way the reforms undertaken by state institutions, territorial reform, reform of the tax system from the viewpoint of public finances.

One of the most difficult problems that public finances in countries in transition is the collection and management of revenue from taxes and fees, a process that is gaining more importance in our country. Local government is responsible for providing a range of services, which can show different characteristics, they may be of public nature, with private nature, but that possess little or no public features.

Territorial reforms aimed at management of public funds, it allows for a more efficient allocation of public investment also supports and encourages local economic development and leads to increased efikasitetit local units. Also a subject of study in this paper will be new fiscal package, its effects on growth of budget revenues, essentially change the structure of the TAP and local taxes, etc.

In conclusion, we can say that the need for greater administrative capacity and financial resources, the need to increase budget revenues and meet growing debt, the need to respect European standards for local services makes it imperative territorial reform.

Keywords: public finance, territorial reform, tax system, investment, local power.

HYRJE

Pushteti vendor në Shqipëri ka filluar funksionimin prej më shumë se 15 vjetësh dhe, pas reformës së decentralizimit të viteve 2000, ka arritur të konsolidohet, si një pjesë e rëndësishme e pushtetit ekzekutiv, në nivel rajonal dhe lokal, për ushtrimin me efikasitet të funksioneve dhe shërbimeve publike. Taksat dhe tarifat vendore, përbëjnë një burim të rëndësishëm financiar të buxhetit të pushtetit vendor dhe për këtë arsye modernizimi i këtij sektori do ishte më se i justifikueshëm. Financat publike janë një problem dhe një debat i hapur kudo, midis grupeve të interesit nga njëra anë dhe shtetit nga ana tjetër. Këto debate synojnë hartimin dhe zbatimin e

politikave ekonomike, sociale e fiskale sa më të përshtatshme për kushtet e vendit tonë. Autonomia vendore është një ndër parimet kryesore për një qeverisje vendore efektive. Decentralizimi i pushtetit dhe rritja e autonomisë së pushtetit vendor janë në lidhje të drejtë lineare me decentralizimin fiskal, pra me rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. Të realizosh shërbime për qytetarët e tu, duhet së pari të kesh një buxhet të mjaftueshëm e solid. Taksat e tarifatat vendore i sigurojnë të zgjedhurve vendorë mundësinë reale, që ata të përmbushin misionin për të cilin janë zgjedhur, të përmbushin prioritetet vendore, pse jo ato të qytetarëve dhe komuniteteve të tyre.

TENDENCAT E FINANCAVE PUBLIKE

Treguesit kryesorë që influencojnë në të ardhmen e financave publike janë:

1-Niveli i borxhit publik

2-Madhësia e shpenzimeve publike

3- Tendenca e tatimeve dhe taksave

1. Raportet e borxhit publik kanë ardhur duke u rritur në këto 30 vitet e fundit. Raporti i borxhit para krizës të vitit 2007 i kishte kaluar 80 % të PBB-së në disa vende dhe shumica e vendeve europiane hynë në krizë me nivele të larta të borxhit. Sfidat e ardhshme për shumë vende, pas krizës është ulja e borxhit publik nën nivelin 60 % të PBB-së deri në vitin 2030, pasi mungesa e një rregullimi të fortë fiskal dhe rritja e borxhit do të sillte efekte negative makroekonomike. “Analiza e re e FMN-së sugjeron se një rritje e borxhit publik mbi 60 %, mund të rrisë normat reale të interesit nga pothuajse 2 pikë përqindje në periudha afat- mesme dhe rritjen më ulët jo më shumë se 0.5pikë përqindje në periudha afat-gjata” (Kumar dhe Eoo, 2010). Pra, sipas kësaj analize, shumë vende, deri në vitin 2015, do kenë diferencë në normën e rritjes ekonomike nga viti në vit e shkaktuar nga shpenzimet e interesit fiskal, ndërsa pas vitit 2016 deri në vitin 2030, norma e rritjes së PBB-së do të jetë një funksion i pas krizës për çdo vend. Kjo do të thotë se, një vend me raport borxhi pas krizës 10 % më të lartë se mesatarja, presupozohet se do të ketë një normë interesi më të lartë për borxhin e marrë dhe anasjelltas.

2. Prirja e dytë fiskale që karakterizon dekadat e fundit është rritja e madhësisë së qeverisë, e matur kjo nga raporti i shpenzimeve publike ndaj PBB-së. Kjo është e vërtetë, si për shpenzimet e përgjithshme, ashtu dhe për shpenzimet kryesore (përfshirë pagesën e interesit). Pjesa më e madhe e rritjes u zhvillua në mes të viteve 1965 dhe 1985, një tendencë e cila ishte e pranishme në të gjitha vendet. Shpesh thuhet se kjo rritje reflekton një ndryshim në natyrën e shtetit: nga një shtet që siguron "funksionet themelore" si siguria e shërbimeve të mbrojtjes, politikës, e drejtësisë dhe veprave të mëdha publike në një shtet që ofron një gamë më të gjerë të shërbimeve sociale (Tanzi, 2005 dhe 2008). Ky konstatim është i saktë, por me një konkluzion të rëndësishëm. Pjesa më e madhe e rritjes së shpenzimeve publike (mbi 80 për qind) është për shkak të dy zërave të shpenzimeve: kujdesit shëndetësor dhe pensioneve. Në veçanti, shpenzimet e kujdesit shëndetësor janë rritur në shumë vende. Në Shtetet e Bashkuara, ato llogariten më shumë se dy të tretat e rritjes së raportit të shpenzimeve primare dhe më shumë se gjysma e shpenzimeve primare në Kanada, Gjermani, dhe Mbretërinë e Bashkuar. Shumë qeveri, për të realizuar qëllimet e tyre politike kanë bërë marrëveshje sociale me qytetarët, duke e vënë theksin në shpenzimet e pensioneve, por shumë më pak si trend në rritje në shpenzimet e kujdesit shëndetësor. Ky është një gabim, pasi reforma e kujdesit shëndetësor do të jetë sfida fiskale e

shkullit të njëzet e një. Për shpenzimet e kujdesit shëndetësor, e ardhmja është shumë më sfiduese. Duke u mbështetur në parashikimet e fundit të Zyrës së Buxhetit të Kongresit të SHBA të shpenzimeve federale për Medicaid dhe Medicare, vlerësimin e stafit të FMN-së se qeveria e përgjithshme e shpenzimeve për shëndetin do të rritet me 4.5 pikë përqindjeje të PBB-së gjatë njëzet viteve të ardhshme, mund të themi se: për Kanadanë dhe Japoninë, kujdesi shëndetësor sipas projektit të stafit të FMN-së do të rritet me rreth 3 pikë përqindje, përkatësisht për secilin vend. Në Evropë, rritja e parashikuar nga Komisioni Evropian është pikë shumë e vogël -0.8 pikë përqindje e PBB-së (Cotarelli, Schaechter, 2010).

Pse është ky dallim kaq i madh? Ky dallim është për shkak të supozimeve të ndryshme në lidhje me ndikimin e faktorëve jo-demografikë, duke përfshirë ndryshimet në çmimin relativ të shërbimeve mjekësore. Në fakt, niveli bazë i BE-së nuk merr në konsideratë faktorë të tillë edhe pse pjesa më e madhe e rritjes të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor në pesëdhjetë vitet e fundit ishte për shkak të komponentëve jo-demografikë, duke përfshirë progresin teknologjik: shërbime më të mira mjekësore janë vënë në dispozicion, por edhe ato më të shtrenjta. Parashikohet që rritja e shpenzimeve të kujdesit shëndetësor në Europë, deri në 2030 do të jetë rreth 3 pikë përqindje. Sfida kryesore e politikës gjatë dekadave të ardhshme do të jetë bërja e sistemeve të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor të qëndrueshme, si dhe krijimin e hapësirës fiskale në fusha të tjera në mënyrë që të përshtaten me preferencat shoqërore.

3.Struktura e të ardhurave të buxhetit të shtetit ka ndryshuar shumë me kalimin e kohës. Rritja më e lartë në pikë përqindjeje e të ardhurave ndaj PBB-së konsiston në rritjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

TAKSAT DHE TARIFAT E PUSHTETIT VENDOR - RASTI I BASHKISË VLORE

Për mbledhjen e të ardhurave të veta tatimore dhe jo-tatimore, njësitë vendore duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë:

a. Llogaritjen e të ardhurave, duke u bazuar në njësinë bazë të masës, ose nivelin ligjor orientues në varësi të llojit të aktivitetit që taksohet. Tregues të tillë mund të jenë: sipërfaqja e tokës, sipërfaqja e ndërtimit të një ndërtese, xhiro vjetore e realizuar, çmim/njësi, vlera mesatare e shitjes së ndërtesave dhe vlera e çdo lloji prone tjetër.

b.Njësinë e vlerësimit, e cila për taksat është quajtur baza e taksës, e cila shërben për vlerësimin e të ardhurave nga një taksë e caktuar. Ky tregues shprehet në vlera për çdo njësi treguese, si: lekë / ha, ose lekë/m².

c.Normën e llogaritjes ose nivelin e taksës. Ky tregues, përfaqëson shumën e të ardhurave/taksave për njësinë llogaritjeje të taksimit. Ai shprehet në shumë/vlerë absolute, ose në përqindje për çdo njësi.

Taksat dhe Tarifat Kryesore Vendore

Taksat vendore përfshijnë

- a) Taksa vendore mbi biznesin e vogël;
- b) Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila përbëhet prej taksës mbi ndërtesat dhe taksës mbi tokën bujqësore;
- c) Taksa e fjetjes në hotel;
- ç) Taksa mbi efektin në infrastrukturë (dëmet) nga ndërtimet e reja;

- d) Taksa mbi të drejtën e transferimit të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme (paguhet vetëm nga bizneset);
 - e) Taksa mbi tabelën;
 - f) Taksë për zënie hapsirash publike
 - g) Taksa të përkohshme.
- Tarifat kryesore vendore përshijnë:
- a) Tarifën e pastrimit rrugor
 - b) Tarifën e ndricimit rrugor
 - c) Tarifa e mbeturinve urbane
 - d) Tarifa e Parkimit
 - e) Tarifa e Regjistrimit
 - f) Tarifa e Tregut
 - g) Tarifa e shërbimeve veterinare
 - gj) Tarifa e gjuetisë

Taksa Vendore mbi Biznesin e Vogël

Kjo taksë e vendosur për herë të parë në vitin 2003 (bazuar në ligjin për taksën vendore mbi biznesin e vogël) parashikonte një shumë fikse sipas kategorive të bizneseve dhe klasifikimit administrativ të njësive vendore.

Deri në fund të vitit 2006 kjo taksë administrohej nga njësitet vendore (për komponentin fikse të taksës) dhe administrata qendrore (për komponentin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin si përqindje mbi xhiron e bizneseve të vogla), ndërkohë që në vitin 2007 kjo taksë kaloi tërësisht nën administrimin e njësive vendore. Taksa mbi biznesin e vogël deri më sot është burimi më i rëndësishëm për njësitet vendore.

Informacioni i QKR-së tregon një rritje të rëndësishme të numrit të bizneseve të vogla të regjistruara (në disa qytete është evidentuar rritje vjetore prej 30%), ndërkohë që të ardhurat e mbledhura nga taksa e biznesit të vogël nuk janë rritur proporcionalisht (bile në disa raste vihet re rënie e të ardhurave). Rënia e ekonomisë është një faktor i rëndësishëm, që ka ndikuar direkt në performancën e saj.

Me paketën e re fiskale, biznesi i vogël do të paguajë *Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël*. Subjektet me qarkullim nga 0 deri në 5 milionë lekë, nuk paguajnë tatim të thjeshtuar mbi fitimin. Subjektet me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë lekë në vit paguajnë 7.5% të fitimit të tatueshëm, si tatim të thjeshtuar të tatimit mbi fitimin dhe subjektet me qarkullim vjetor mbi 8 milionë lekë paguajnë 15 % të fitimit të tatueshëm.

Sipas relacionit të Ministrisë së Financave, aktualisht në Shqipëri zhvillojnë aktivitete si subjekte të biznesit të vogël rreth 60 mijë tatimpagues. Nga pikëpamja fiskale, pagesa e kësaj takse te bashkitë dhe komunat dhe më pas kreditimi i saj në administratën qendrore tatimore, në funksion të tatimit të të ardhurave personale ka rritur abuzimin dhe nënraportimet, duke e bërë tatimin mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël si një tatim josolid në sistemin fiskal. Ndër vite, taksa e biznesit të vogël e ka humbur rëndësinë e saj dhe është shndërruar në një barrë të tepërt tatimore për këtë kategori biznesesh.

Për këtë arsye, tatimi mbi të ardhurat personale i biznesit të vogël në normën prej 7.5% e fitimit të tatueshëm (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura fiskalisht) do të

konsolidojë këtë taksë, duke e pastruar nga kreditimi i taksës së biznesit të vogël, si dhe i ofron lehtësi tatimore kësaj kategorie. Në paketën e re fiskale parashikohet heqja e taksës së biznesit të vogël dhe në ligjin për tatimin mbi të ardhurat, heqja e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël. Këto dy tatime, të cilat biznesi i vogël i paguan te njësitë e qeverisjes vendore dhe tek administrata tatimore qendrore, zëvendësohen me një tatim të vetëm, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Rishikimi i Taksës së Ndërtesës

Në kushtet aktuale ka një mungesë të theksuar administrimi në mbledhjen e kësaj takse nga njësitë e qeverisjes vendore, sidomos për taksat e ndërtesës, që përdoren për qëllime banimi. Ndryshmet në paketën e re fiskale përfshijnë: heqja e vitit të ndërtimit të ndërtesës, si vit ndarës i taksimit dhe njehsimit të taksës së ndërtesës së ndërtuar para vitit 1993 me atë të ndërtesës së ndërtuar pas vitit 1993, si dhe një ndryshim të nivelit të taksës së ndërtesës për qëllime biznesi, duke e dyfishuar vlerën e saj për m².

Kjo reformë do të gjenerojë rreth 1.1 miliardë lekë në buxhetet e njërive të qeverisjes vendore. Paralelisht qeveria është duke ripunuar dhe me modelin e taksimit të taksës së ndërtesës sipas vlerës së tregut, reformë kjo e cila do të prezantohet në vitet në vijim. Diferencimi i vlerës së taksës mbi pasurinë bëhet në bazë të vendndodhjes së pasurisë edhe përdorimit të tyre. Me hyrjen në fuqi të paketës së re fiskale personat fizikë dhe juridikë do të paguajnë dyfishin e vlerës, që paguanin më parë. Nga 156 lekë/m² bizneset do të paguajnë 300 lekë/m². Personat fizikë, të cilët kanë më shumë se një shtëpi, për shtëpinë, të cilën e kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës sipas vlerës së përcaktuar për zonën ku ajo ndodhet, ndërsa për të gjithë shtëpitë e tjera taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës që aplikohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.

FINANCAT VENDORE

Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelare, Buxhetin e Bashkisë:

Figura 1: Buxheti i Bashkisë

Të ardhurat	Shpenzimet
1. Të ardhurat e veta	1. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes
<ul style="list-style-type: none"> Taksat vendore Tarifat vendore Të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe jo ekonomike Huatë vendore 	2. Shpenzimet kapitale
	Ose
	1. Shpenzimet për funksionet e veta (shërbimet publike)
2. Të ardhurat nga buxheti shtetit	2. Shpenzimet për funksionet e përbashkëta (arsimi, shëndetësia)
<ul style="list-style-type: none"> Transferta e pakushtëzuar-Granti i përgjithshëm Transferta e kushtëzuar-Granti konkurrues Tatimet kombëtare të ndara 	3. Shpenzimet për funksionet e deleguara (gjendja civile)

Të Ardhurat Vendore

Pushteti vendor, si rrjedhojë e zbatimit të reformës për decentralizimin është fuqizuar financiarisht në fonde që sigurohen nëpërmjet instrumentave financiarë gjithnjë në rritje nga viti në vit. Megjithatë, financat vendore mbeten ende modeste në totalin e buxhetit të konsoliduar të shtetit, ato zënë vetëm 11% të tij ose 3.14% të prodhimit të brendshëm bruto (kundrejt 28.5% të PBB-së që është gjithë buxheti i shtetit).¹

Dhjetëvjeçari i parë i decentralizimit vendor deri në vitin 2000 karakterizohet nga një pushtet vendor, që ofron shërbime në nivele minimale për komunitetin dhe një buxhet që shkon pothuajse për paga dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe institucioneve publike vendore. Kështu nëse në vitin 2000 investimet zinin mbi 20% të buxhetit të pushtetit vendor, në fund të këtij dhjetëvjeçari arrijnë në rreth 40%; ndërkohë që edhe struktura e shpenzimeve korente ka zvogëluar peshën e pagave dhe rritur ato për mirëmbajtje (ku 24% shkojnë për paga dhe sigurime dhe 38% për mirëmbajtje).

Duke analizuar figurën 2 vihet re se raporti midis transfertës së pakushtëzuar të dhënë nga buxheti qendror dhe të ardhurave të pushtetit lokal ka ndryshuar në favor të këtyre të fundit. Ky ndryshim, në dukje pozitiv, lidhur me rritjen e autonomisë financiare të pushtetit lokal është shoqëruar në mënyrë konstante me realizime të ulëta në mbledhjen e të ardhurave në nivele rreth 70 - 77 përqind, duke nxjerrë në pah vështirësitë dhe kapacitetet e pakonsoliduara të pushtetit lokal në këtë drejtim.

Për shkak të kësaj situate, qeveria ka vendosur të centralizojë mbledhjen e tatimit të biznesit të vogël, tatim i cili përbën rreth 21 përqind të të ardhurave të pushtetit vendor duke u klasifikuar i dyti për nga rëndësia. Për vitin 2015, të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Vlorë janë në shumën 916,345,000 lekë. Përveç të ardhurave me natyrë fiskale, njësitë e pushtetit vendor mund të krijojnë të ardhura edhe nga veprimtaritë ekonomike, qeratë, shitjet e pronave, nga donacione, të ardhura nga interesat dhe nga gjobat.

Të ardhurat nga taksat vendore: mbliidhen për këto kategori: taksa mbi pasurinë, taksa e biznesit të vogël, taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, taksa e mjeteve të përdorura, taksa e tabelës, taksa për zënieën e hapësirave publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja si dhe taksa e fjetjes në hotel. Në kuadrin e taksave që aplikon dhe mbledh kjo bashki, taksa më e rëndësishme është taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Kjo taksë përbën 44% të të ardhurave nga taksat vendore për vitin 2015 krahasuar me vitin 2010, ku kjo taksë kishte një peshë 78% të të ardhurave nga taksat dhe zbret në 59% në vitin 2011. Kontributi kaq i madh i kësaj takse në buxhetin e kësaj njësie vendore reflekton volumin e madh të ndërtimeve në këtë qytet. Për vetë natyrën e kësaj takse edhe ecuria e saj është e paqëndrueshme dhe varet tërësisht nga numri i lejeve të ndërtimit. Kontributi i kësaj takse ka ardhur në rënie nga viti në vit. Plani i ri rregullues i qytetit ndoshta edhe për një periudhë tjetër afatgjatë do të sjellë një ulje të mëtejshme të të ardhurave të bashkisë nga kjo taksë.

Të ardhurat nga tarifat: zënë 13% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta. Kjo bashki ka një paketë fiskale ku dallon qartazi taksat dhe tarifat që aplikon, nuk ka dublime në natyrën (përshkrimin e tyre, bazën mbi të cilën aplikohen) dhe trendi i përgjithshëm i tyre është në rënie. Nga 111,642,000 lekë që ishin në vitin 2010, sot pothuajse janë përgjysmuar në 65,087,000 lekë. Ashtu sikurse edhe në njësitë e tjera vendore tarifa më e rëndësishme është ajo e pastrimit e cila jep 58% të të ardhurave nga tarifat.

¹ Ministria e Financave

Shpenzimet e Pushtetit Vendor

Në tërësi, buxheti vendor ka një strukturë të tillë ku 62% zënë shpenzimet operative dhe 38% investimet. Në kuadrin e shpenzimeve operative, peshën më të madhe e kanë ato për mirëmbajtje me rreth 60% të totalit të shpenzimeve operative dhe pjesa tjetër shkon për të përballuar koston e personelit të administratës vendore.

Shpenzimet bashkiake bëhen kryesisht për:

1. Mirëmbajtjen dhe riparimin e kopshteve bashkiake dhe ndërtesave shkollore,
2. Transportin vendor publik,
3. Riparimin e rrugëve vendore,
4. Ndërtimin e sistemit të ujrave të zeza,
5. Kontributet për ambientet kulturore,
6. Rrogat e zyrtarëve dhe punonjësve të tjerë bashkiake, duke përfshirë pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 7 përqind të shpenzimeve korente. Për vitin 2015, ato kanë arritur në 28,579 miliardë lekë. Krahasuar me një vit më parë, këto shpenzime rezultojnë rreth 924 milionë lekë më të ulëta ose rreth 3,1 përqind më pak. Si rrjedhojë, shpenzimet e pushtetit vendor arritën në rreth 2.1 përqind të PBB-së, ndërkohë që edhe një vit më parë këto shpenzime përfaqësonin rreth 2.1 përqind të PBB-së.

Shpenzimet përbëhen nga: shpenzime për pastrimin, për gjelbërimin, për ndërrmarjen e shërbimeve publike, për sektorin e ndriçimit rrugor, për sistemin arsimor 9-vjeçar, për Çerdhet, për Qendrën e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve dhe shpenzimet për Parkun Urban si dhe shpenzime për administratën e Bashkisë për paga dhe sigurime shoqërore, për teatrin “Petro Marko” dhe Sh.A Ujësjiellës-Kanalizime.

Një pjesë e këtyre shpenzimeve mbulohen nga të ardhurat nga burimet e veta, pra kryesisht nga taksat vendore dhe një pjesë nga granti apo transfertat e pushtetit qëndror.

Shpenzime nga të ardhurat (plan)	875.353 (000 lekë)
nga keto:	
a. Për pagat (600)	88.740
b. Për sigurimet shoqërore (601)	23.101
c. Për shpenzime operative (602)	481.243
d. Për transfertat (166+ 606+651)	19.431
e. Për subvencion (603 - Parku Urban- Futbolli)	63.100
f. Për emergjencat civile (604)	1.000
g. Për fondin rezervë (609)	16.196
h. Për investime (231)	182.542
Shpenzime nga granti	376.152
nga këto:	
a. Për pagat (600)	120.619
b. Për sigurimet shoqërore (601)	10.798
c. Për shpenzime operative (602)	125.136
d. Për subvencion (603 - Parku Urban-Futbolli-Ujësjiellës)	115.579
e. Pagesë për shlyerje kredie (166+651)	4.020

TAKSAT VENDORE NË SHQIPËRI KRAHASUAR ME VENDET E TJERA

Në Itali dhe Norvegji, më pak se 6% e të ardhurave lokale vijnë nga taksmi lokal dhe ka një mbështetje nga grantet e qeverisë. Në Gjermani, Spanjë, Luksemburg dhe Portugali ka një përdorim të gjerë të “taksave të ndara”. Taksat lokale variojnë gjerësisht nga njëri vend në tjetrin, mbështetur në modele të ndryshme, megjithatë, së fundmi të gjitha vendet përdorin taksën e pronës. Shqipëria renditet e fundit për sa i përket të ardhurave të qeverisjes vendore si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB);

- Shqipëria renditet e treta nga fundi për sa i përket të ardhurave për frymë të NJQV-ve në 737 euro, duke lënë prapa vetëm Kosovën me 587 euro dhe Moldavinë me 518 euro.
- Shqipëria renditet e dyta nga fundi për sa i përket mbledhjes së taksës së pasurisë si përqindje e PBB-së në 2011 me vetëm 0.18 përqind, duke lënë pas vetëm Kroacinë që e ka këtë shifër në 0.13 përqind.
- Shqipëria renditet e fundit në lidhje me investimet e qeverisjes vendore si përqindje e PBB-së (mesatarja 2006-2011) në 0.9 përqind.
